



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA E BUKETËS, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	AGJENCIA E BUKETËS, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRIA E BUKETËS, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	MINISTRIA E BUKETËS, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUKETËS	AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUKETËS
AGENCY FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT	AGENCY FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT
NUMERI: 07/4	NR. PROJ. 3642
NR. TIKER 121	DATA 13.07.2017
NR. BUKETËS	DATA
	PECENTIMË A

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2016

AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË





Referencat

Tabela e përmbajtjes

Referencat	2
Akronimet (Shkurtesat)	5
Lista e tabelave	6
Lista e figurave	8
DIVIZIONI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME	10
Organizimi i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.....	10
Organogrami i AZHB-së sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm	11
DIVIZIONI I MIRATIMIT TË PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT RURAL	28
1.Masa 101 „Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore”	28
2.Masa 103 „Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore”	29
3.Masa 302 „ Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale”	29
4. Masa „ Ujitja e tokave bujqësore”	29
5. Masa 303 „Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale- qasja Leader”	29
Shqyrtimi administrativ,vlerësimi,kontrolli në terren dhe Miratimi i Projekteve të Zhvillimit Rural	34
Vështirësitë gjatë miratimit të PZHR-së për vitin 2016.	40
DIVIZIONI I AUTORIZIMIT TË PAGESAVE	41
Masa 101 - Ristrukturimi i potencialit fizik në sektorin agro-rural.....	41
Masa 103 - Investimet në Përpunim dhe Marketing të Prodhimeve Bujqësore.....	41
Masa 302 - Investimet në Përpunim dhe Marketing të Prodhimeve Bujqësore.....	41
Masa 303 - Zbatimi i Strategjive Zhvillimore Lokale qasja LEADER dhe.....	41
Masa - Ujitja e Tokave Bujqësore	41
Vështirësitë gjatë implementimit të programit për vitin 2016.....	46
DIVIZIONI I PAGESAVE DIREKTE	47
Pagesat Direkte për mbjellje vjeshtore - Grurë	48
Pagesat Direkte - Farë Gruri	51
Pagesat Direkte - Misër	53
Pagesat Direkte - Elb.....	55
Pagesat Direkte - Thekër	56
Pagesat Direkte për bimë vajore - Luledielli	57



Pagesat Direkte - Perime në fushë të hapur	58
Pagesat Direkte - Pemishte ekzistuese.....	60
Pagesat Direkte - Vreshtari.....	62
Pagesat Direkte - Bujqësi Organike	64
Pagesat Direkte për Blegtori - Lopë Qumështore dhe buallica	64
Pagesat Direkte për kafshë të imta - Dele dhe Dhi.....	66
Pagesat Direkte - Bletë.....	70
Pagesat Direkte - Thëllëza	72
Pagesat Direkte - Material fidanor.....	72
Pagesat Direkte - Pula vojse.....	74
Pagesat Direkte - Dosa.....	76
Pagesat Direkte - Qumësht sipas cilësisë.....	77
Pagesat Direkte për therrjet e raportuara të gjedhit.....	78
Përmbledhje e Pagesave Direkte	79
DIVIZIONI I KONTROLLIT	82
KONTROLLI I MASAVE TË ZHVILLIMIT RURAL.....	85
Masa-101- Investimet në Asetet Fizike në Ekonomitë Bujqësore.....	87
Masa-103- Investimet në Asetet Fizike në Përpunimin dhe Tregtimin e Produkteve Bujqësore dhe atyre të Peshkatarisë.....	87
Masa-302- Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve Rurale.....	88
Masa-303- Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale (LEADER)	88
Masa Ujitja- Skema për Ujitjen e Tokave Bujqësore.....	88
Vështirësitë gjatë kontrollit në terren për Projektet e Zhvillimit Rural.....	93
KONTROLLI PËR MASAT E PAGESAVE DIREKTE-SUBVENCIONET.....	93
Kontrolli i Grurit	94
Kontrolli i Misrit dhe Lulediellit	94
Kontrolli i Elbit dhe Thekrës	95
Kontrolli i Perimeve në fushë të hapur	95
Kontrolli i Pemishteve	95
Kontrolli i Vreshtave	95
Kontrolli i Kafshëve dhe Bletëve	95
Kontrolli i Materialit Fidanor.....	96



Kontrolli i Pulave Vojse.....	96
Kontrolli i Fëllanzave	96
Kontrolli i Fëllanzave	96
Kontrolli i Bujqësisë Organike	96
Shqyrtimi i Ankesave.....	96
Kontestet	96
Vështirësitë në teren gjatë kontrollit të Pagesave Direkte	99
DIVIZIONI I IT & REGJISTRAVE.....	101
Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR).....	105
Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS).....	109
Softueri Grant Menaxhmenti.....	115
Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte	118
Softueri për Indikator.....	120
Web faqja.....	121



Akronimet (Shkurtesat)

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

AZHB – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

AM - Autoriteti Menaxhues

BB – Banka Botërore

DAP – Departamenti i Administratës së Përgjithshme

LPIS – Sistemit të Integruar të Menaxhimit dhe Identifikimit të Parcelave

MF SIMFK – Ministria e Financave Sistemi i Menaxhimit të Financave Kosovë

APK – Agjencia e Pyjeve të Kosovës

AUK – Agjencia e Ushqimit të Kosovës

U/A – Udhëzues Administrativ

PD – Pagesa Direkte

PZHR – Projektet e Zhvillimit Rural

DAPZHR – Divizioni i Autorizimit të Pagesave për Projektete e Zhvillimit Rural

eFR – Regjistri Elektronik e Fermerëve

NIF- Numri Identifikues i Fermës



Lista e tabelave

Table 1 Numri i punëtorëve gjatë vitit 2016 në AZHB	14
Table 2 Struktura profesionale e të punësuarve ne vitin 2016	15
Table 4 Numri i të punësuarve në Divizione-2016	17
Table 5 Raporti i shpenzimeve të derivateve për vitin 2016.....	20
Table 6 Raporti i kilometrave të kaluara sipas muajve	22
Table 7 Numri i ankesave	24
Table 8 Buxhetit i paraparë për PZHR 2016	30
Table 9; Numri dhe vlera e aplikimit Masa 101.....	32
Table 10; Numri dhe vlera e aplikimit –Masa 103.....	32
Table 11: Numri dhe vlera e aplikimit –Masa 302.....	33
Table 12: Numri dhe vlera e aplikimit- Masa 303	33
Table 13 Numri dhe vlera e aplikimit- Masa e Ujitjes.....	33
Table 14: Numri i projekteve dhe vlera e miratuar për vitin 2016	35
Table 15:Numri i aplikacioneve, Të refuzuara, të miratuara dhe të vlerësuara.....	36
Table 16 Tabela krahasuese mbi numrin e aplikacioneve - PZHR -2012-2013-2014-2015-2016.....	37
Table 17: Krahasimi i vlerave të projekteve sipas viteve	40
Table 18: Numri dhe vlera e projekteve pas autorizimit për masën 103/2016	41
Table 19: Numri dhe vlera e projekteve pas autorizimit për masën Ujitje/2016	42
Table 20: Numri dhe vlera e projekteve pas autorizimit për masën 101/2016.....	43
Table 21 Numri dhe vlera e projekteve pas autorizimit për masën 302/2016	44
Table 22 Totali i vlerave të projekteve pas autorizimit per të gjitha masat /2016	45
Table 23: Totali i projekteve pas autorizimit /2016.....	45
Table 24: Numri i projekteve të refuzuara.....	46
Table 25:Përfituesit, te refuzuarit dhe shuma e pagesës sipas komunave, grurë 2016.....	46
Table 26: Pëfituesit dhe sipërfaqja e subvencionuar për prodhuesit e farës së grurit sipas komunave.....	48
Table 27 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave.....	54
Table 28 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Elb 2016.....	56
Table 29 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Theker 2016	57
Table 30 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Luledielli 2016.....	58
Table 31 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Perime ne fushe te hapur, 2016.....	59
Table 32 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Pemishte ekzistuese, 2016.....	61
Table 33 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – Vreshta ekzistuese, 2016	63
Table 34 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe sipërfaqja e subvencionuar sipas komunave – bujqësi organike, 2016	64



Republika e Kosovës
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

Table 35 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe kreret e subvencionuar sipas komunave – lopë qumështore dhe buallica, 2016	65
Table 36 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe kreret e subvencionuar sipas komunave – Dele 2016.....	67
Table 37 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe kreret e subvencionuar sipas komunave – Dhi 2016.....	69
Table 38 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe kosheret e subvencionuara –Bletë 2016	71
Table 39 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe kreret e subvencionuara –Thëllëza 2016.....	72
Table 40 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe numri i fidanëve të subvencionuar sipas komunave 2016	73
Table 41 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe numri i pulave të subvencionuara sipas komunave, 2016	74
Table 42 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe numri i dosave të subvencionuara sipas komunave, 2016	76
Table 43 Numri i përfituesve dhe pagesa sipas komunave,qumësht sipas cilësisë 2016	78
Table 44 Totali i aplikuesve,përfituesve të refuzuarve dhe shuma e pagesës sipas pagesave për vitin 2016.	80
Table 45 Kontrolli i granteve të mbetura nga v. 2015, Rikontrollet dhe Superkontrollet dhe Monitorimi (EX-Post) të realizuara në vitin 2016.....	86
Table 46 Struktura dhe Korniza Kohore e zbatimit të Kontrolleve të PZHR-ve në vitin 2016	91
Table 47 Krahasimi i numrit të kontrolleve sipas kategorive 2015/2016.....	92
Table 48Krahasimi i kontrolleve për Pagesa Direkte sipas viteve	97
Table 49 Qarkullimi i Lëndëve për Pagesa Direkte gjatë vitit 2016,Pranimi,Kontrolli,Kthimi dhe % e kontrollit të Realizuar	98
Table 50: Numri i tërësishëm i aplikantëve,numri i aplikantëve të kontrolluar dhe %.....	99



Lista e figurave

Figure 1 Organogrami i AZHB-së	11
Figure 2 Propozimi i Organogramit të ri të AZHB-së	12
Figure 3 Të punësuar sipas muajve 2016	14
Figure 4: Raporti i të punësuarve ne v. 2016	15
Figure 5: Struktura profesionale e të punësuarve në v. 2017	16
Figure 6: Struktura gjinore e të punësuarve	16
Figure 7: Numri i të punësuarve në Divizione	17
Figure 8; Derivatet e shpenzuara sipas muajve ne v. 2016	20
Figure 9: Sasia e derivateve të shpenzuara sipas veturave	21
Figure 10: Shpenzimi i derivateve	21
Figure 11 :Grafikoni i kilometrave të kaluara	22
Figure 12 :Grafikoni i ankesave	25
Figure 13 :Plani i paraparë për realizimin e miratimit të PZHR-së 2016	31
Figure 14: Numri i projekteve dhe vlera e miratuar per vitin 2016	36
Figure 15:Gjendja e aplikacioneve pas vlerësimit	38
Figure 16: Krahasimi i numrit të aplikacioneve - PZHR -2012-2013-2014-2015-2016	38
Figure 17: Gjendja e aplikacioneve pas vleresimit.....	39
Figure 18: Numri dhe vlera e projekteve pas autorizimit për masën 103/2016.....	42
Figure 19: Numri dhe vlera e projekteve pas autorizimit për masën 101/2016.....	43
Figure 20 :Numri dhe vlera e projekteve pas autorizimit për masën 302/2016.....	44
Figure 21: Numri i perfituesve te paguar sipas masave	46
Figure 22: Shumat e pagesave për PD-në -Grurë për vitet 2014, 2015 dhe 2016	51
Figure 23:Krahasimi i shumës së pagesës për farë gruri për vitet 2014,2015 dhe 2016.....	53
Figure 24 :Krahasimi i shumës së pagesave për misër për vitet 2014, 2015, 2016	55
Figure 25 :Krahasimi i shumës së pagesave për luledielli për vitet 2014,2015,2016	58
Figure 26: Krahasimi i shumës së pagesave për Perime në fushë të hapur për vitet 2014,2015,2016	60
Figure 27 :Krahasimi i shumës së pagesave për Pemishte ekzistuese për vitet 2014,2015,2016	62
Figure 28 :Krahasimi i shumës së pagesave për vreshta ekzistuese për vitet 2014,2015,2016	63
Figure 29 :Krahasimi i shumës së pagesave për lopë qumështore dhe buallica për vitet 2014, 2015, 2016 ..	66
Figure 30 :Krahasimi i shumës së pagesave për Pagesa Direkte-Dele për vitet 2014,2015,2016.....	68
Figure 31: Krahasimi i shumës së pagesave për Pagesa Direkte-Dhi për vitet 2014, 2015, 2016	70
Figure 32 :Krahasimi i shumës së pagesave per Pagesa Direkte-Bletë për vitet 2014, 2015, 2016	72
Figure 33:Krahasimi i shumës së pagesave për Pagesa Direkte-Material fidanor për vitet 2014, 2015,2016	73
Figure 34: Krahasimi i shumës së pagesave për Pagesa Direkte-Pula vojse për vitet 2014, 2015, 2016	75
Figure 35 :Krahasimi i shumës së pagesave për Pagesa Direkte-Dosja për vitet 2014, 2015, 2016	77
Figure 36 :Paraqitja grafike e shumës së pagesave direkte për vitet 2014, 2015 dhe 2016	81
Figure 37 :Paraqitja grafike e krahasimit	92
Figure 38 :Lidhja e regjistrave të AZHB-së	103
Figure 39 :Sistemi i komunikimit të AZHB-së	104
Figure 40 :Numri i fermerëve të regjistruar nëpër vite 2012-2016	106



Republika e Kosovës
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

<i>Figure 41:Procesi i regjistrimit të fermerit në eFR</i>	<i>107</i>
<i>Figure 42 :Regjistri elektronik i fermerëve.....</i>	<i>108</i>
<i>Figure 43 :Lidhja e sLPIS –it me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit</i>	<i>109</i>
<i>Figure 44 :Skema e funksionimit të sLPIS dhe sLPIS -Mobile</i>	<i>110</i>
<i>Figure 45 :Numri i fermerëve që kanë aplikuar përmes sLPIS-it, numrin e parcelave dhe sipeërfaqen e digjitalizuar gjatë kampanjave për aplikim për subvencione 2011/12, 2012/13, 2014.....</i>	<i>112</i>
<i>Figure 46: Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS)</i>	<i>113</i>
<i>Figure 47 :LPIS-Mobile</i>	<i>114</i>
<i>Figure 48 :Softueri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë</i>	<i>115</i>
<i>Figure 49 :Softuerin për menaxhimin e granteve</i>	<i>116</i>
<i>Figure 50.:Softuerin për autorizimin e pagesave.....</i>	<i>117</i>
<i>Figure 51 :Moduli i Kontrollit.....</i>	<i>118</i>
<i>Figure 52 :Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte</i>	<i>119</i>
<i>Figure 53:Softueri për indikator.....</i>	<i>120</i>
<i>Figure 54.:Web faqja e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.....</i>	<i>120</i>



DIVIZIONI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Organizimi i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë e themeluar me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr. 04/L-090 për ndryshim plotësimin e Ligjit me nr. 03/L-98 si Agjenci Ekzekutive në kuader të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për implementimin e programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duke zbatuar rregulloret dhe procedurat e shkruara për implementimin e Pagesave Direkte dhe Projekteve për Zhvillim Rural.

Duke u bazuar në kërkesat e IPARD II dhe kërkesat e kohës, nevojën për avansimin e AZHB-së gjatë vitit 2016 në bashkëpunim me projektin e KE për mbështetje Ministrisë është punuar në hartimin e rregullorës së re për Detyrat, Përgjegjësitë, Kompetencat dhe Strukturën Organizative të AZHB-së e cila është kompatible me kërkesat e IPARD-it sa i përket organizimit të Agjencive të Pagesave, drafti final i kësaj rregullore është proceduar në zyrën Ligjore të MBPZHR-së për procedim të metejmë. Sipas rregullorës së brendshme të AZHB-së, rregullore e cila është miratuar nga MAP por nuk është funksionalizuar për mungesë të buxhetit gjatë vitit 2016, numri i të punësuarve duhet të jetë 121 prej tyre 72 në zyrat qendrore dhe 49 në shtatë zyrat regjionale të AZHB-së.



Organogrami i AZHB-së sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm




Figure 1: Organogrami i AZHB-së



Bazuar në propozim rregullorën e re për Detyrat, Përgjegjësitë, Kompetencat dhe Strukturën Organizative të AZHB-së do të ketë ndryshime të konsiderueshme në organogramin e AZHB-së gjithnjë duke u bazuar në kërkesat sipas IPARD –it e që janë propozuar nga ekspertët e projektit të KE i cili ka propozuar këtë strukturë organizative.

Propozimi i Organizimit të ri të AZHB-së




Figure 2 :Propozimi i Organogramit të ri të AZHB-së

AZHB sipas propozim organogramit të ri i cili është kompatibel me kërkesat e IPARD II do të ketë tetë drejtori dhe dy sektorë në vartësi të Drejtorit të Përgjithshëm me detyra dhe përgjegjësi të ndara. Kjo strukturë organizative e AZHB-së do të jetë përgjegjëse për implementimin e programeve për mbështetje nga buxheti nacional dhe nga donatorët bazuar në direktivat dhe kërkesat e BE-së dhe do të mundësojë shfrytëzimin e fondeve nga BE-ja për bujqësi dhe zhvillim rural.

Edhe viti 2016 u karakterizua me mangësi të mëdha në staf , mallra dhe shërbime për shkak të mungesave buxhetore për regrutimin e stafit të nevojshëm e furnizime me mallra dhe shërbime.

Nuk janë funksionalizuar të gjitha Drejtoritë dhe Sektorët sipas rregullorës së brendshme të organizimit të AZHB-së, kanë qenë funksionale vetëm gjashtë Divizione me përgjegjësi të përcaktuara sipas rregullorës për themelimin e AZHB-së, nuk pati mundësi për funksionalizimin e divizioneve tjera si dhe nuk u ngrit niveli i divizioneve në drejtori.



Mbetet sfidë gjatë vitit 2017 themelimi i drejtorive në AZHB sipas organogramit të ri e posaqërisht drejtorisë së financave dhe auditorit të mbrendshëm si nevojë imediate dhe kërkesë edhe nga KE.

Zyrat regjionale të AZHB-së gjatë vitit 2016 janë fuqizuar me staf të ri duke i'u falenderuar bashkëpunimit të mirë me BB-në. Edhe gjatë këtij viti ka vazhduar aktiviteti i zyrave regjionale në procesin e aplikimit dhe pranimit të pakos për pagesë për programin e Zhvillimit Rural, kurse procesi i aplikimit për Pagesa Direkte vazhdon të kryhet nga Drejtoritë Komunale për Bujqësi sipas marrëveshjes me Komunat.

Gjatë procesit të hartimit të buxhetit për KASH ka vazhduar kërkesa për mbulimin e nevojave për staf, mallra dhe shërbime të cilat janë realizuar pjesërisht dhe do të jenë të pa mjaftuara për funksionalizimin e plotë të strukturës organizative por dhe zbatimin e aktiviteteve të planifikuara. Mbetet që gjatë vitit 2017 të vazhdohet me kërkesa për mbulimin e nevojave gjatë rishikimit të buxhetit por edhe nga donatorët. Në vitin 2017 do të behën përpjekje për sigurimin e buxhetit nga MF ose nga donatorët për ngritjen e nivelit të divizioneve në drejtori, plotësimin e stafit të nevojshëm e sidomos formimin e drejtorisë së financave dhe auditorit të jashtëm në kuadër të AZHB-së

Edhe gjatë vitit 2016, AZHB është përballur me mungesë të madhe të stafit për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara për implementimin e programeve mbështetëse e sidomos në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016, të cilat deri në një masë është plotësuar duke angazhuar staf me kontrata për shërbime të veçanta nga buxheti i MBPZHR-së shtatë zyrtarë dhe me mbështetje nga BB, 19 zyrtarë si dhe studentë praktikantë.

Gjatë vitit 2016 kanë qenë të punësuar prej 68 punëtorë në maj, deri në maksimum 94 në muajt shtator-dhjetor. Nga ky numër i përgjithshëm i të punësuarve 34 kanë qenë punëtorë të rregullt, 19 nga BB, 15-41 me kontratë për shërbime të veçanta dhe mesatarisht 4 studentë praktikantë në fillim të vitit.

Stafi ekzistues me angazhime maksimale shpeshë herë ka pasur vështirësi në përmbylljen e aktiviteteve të planifikuara, kështu që në vllugun më të madh të kontrollave administrative dhe kontrollave në terren jemi detyruar të angazhojmë një pjesë të stafit për punë jasht orarit gjatë ditëve të punës dhe për vikend për të kry aktiviteteve të planifikuara me kohë dhe cilësi.



Muajt	Punëtor të rreg.	BB	KSHV	Student Praktikant	Totali
Janar	34	19	15	4	72
Shkurt	34	19	15	4	72
Mars	34	19	15	4	72
Prillë	34	19	15	4	72
Maj	34	19	15		68
Qershorë	34	19	23		76
Korrik	34	19	26		79
Gusht	34	19	26		79
Shtator	34	19	41		94
Tetor	34	19	41		94
Nentor	34	19	41		94
Dhjetor	34	19	41		94

Table 1: Numri i punëtorëve gjatë vitit 2016 në AZHB




Figure 3 :Të punësuar sipas muajve 2016

Gjatë këtij viti raporti i të punësuarve me kontrata të rregullta dhe atyre me kontrata për shërbime të veçanta ka ndryshuar krahasuar me vitin paraprak duke e rrit numrin e të punësuarve me kontrata për shërbime të veçanta për të mundësuar finalizimin e aktiviteteve të planifikuara për implementimin e programeve mbështetëse për vitin 2016.



Kjo strukturë ma së miri shihet në tabelën nr.1 dhe në grafikonin pasues:




Figure 4: Raporti i te punësuarve ne v. 2016

Struktura e të punësuarve sipas përgatitjes profesionale në AZHB është e dominuar nga punëtorët me përgatitje të lartë profesionale të profilit Agronom dhe Ekonomist afërsisht 77.10 % kurse profesionet tjera 22.90 %.

Nr rend	Pergatitja Profesionale	Numri i të punësuarve	Pjesmarrja ne %
1	Agronom	41	42.708333333
2	Ekonomist	33	34.375
3	Jurist	7	7.291666667
4	Veteriner	1	1.041666667
5	Shkenca Kompjuterike/TI	1	1.041666667
7	Të tjerë	8	8.333333333
8	Shkolla e mesme	3	5.208333333
	Gjithsejt	94	100

Table 2 :Struktura profesionale e të punësuarve në vitin 2016




Figure 5: Struktura profesionale e te punesuarve ne v. 2017

Nr rend	Gjinia e te Punesuarve	Numri
1	Femra	27
2	Meshkuj	67
	Total	94

Table 3 :Struktura Gjinore e të punësuarve 2016




Figure 6: Struktura gjinore e të punesuarve



Nr ren.	Divizioni	Punt. te rregullt	KSHV	Me Marveshje	Student/Praktikant	Totali
1	Zyra e KE	1	1			2
1	Administrata	3	4			7
2	PZHR	4	2	2		8
3	PD	2	15			17
4	AP	1	2	1		4
5	TI	1	2	2		5
6	Kontrolli ne Teren	22	15	14		51
	Totali	34	41		0	94

Table 4: Numri i të punësuarve në Divizione-2016




Figure 7: Numri i të punësuarve në Divizione

AZHB që nga fillimi i vitit 2016 është vendosur në objektin e ish Bankës së Lublanës në dy kate 7,8 në një hapsirë të përgjithshme prej 1000 m². Ky objekt edhe pse me infrastrukturë të mirë ka pasur mangesi të konsiderueshme që në disa raste ka qenë pengesë për mbarevajtjen e aktiviteteve. Problemi më i mëdh në këtë objekt është paqartësia e pronësisë e si pasoj edhe mungesat e ndryshme: mungesa e klimatizimit, mungesa e ngrohjes qëndrore, mungesa e elevatorit , mungesa të shpeshta të ujit etj.

Paqartësia e pronësisë së objektit shpesh ka sjell edhe paqartesi dhe probleme në pagesen e shpenzimeve të përbashkëta si rryma dhe komunalit me ç'rast kemi qenë të shternguar të hajtojmë marrëveshje për shpërndarjen e shpenzimeve te institucionet e vendosura në objekt.

Me planifikimin buxhetor për vitin 2016 AZHB ka pasur të planifikuara 800.000 euro për ndertimin e



objektit, por për shkak të pamundësisë për të siguruar lokacion ky buxhet mbeti pa u shfrytëzua edhe përkunder asaj se ishte formuar një komision për zhvillimin e procedurave për sigurimin e lokacionit dhe procedurave për sigurimin e lejeve të ndertimit duke perfshi edhe projektin ideor. Ky komision ka zhvilluar aktivitete për sigurimin e lokacionit dhe lejeve të ndertimit por pa sukses nga se nuk arriti të siguroi lokacion për ndertim.

Në kuadër të angazhimeve për bashkëpunim me institucione tjera AZHB edhe gjatë vitit 2016 ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione tjera dhe palë me interes me qëllim të marrjes së shërbimeve dhe shkëmbim të informacioneve. Gjatë këtij viti është vazhduar marrëveshja e bashkëpunimit me AUV për shfrytëzimin e veturave për realizimin e kontrollit në teren.

Marrëveshje me BB për regrutimin e 19 zyrtarëve me KSHV në afat prej 3+6 muaj në vitin 2017 me qëllim të përkrahjes së aktiviteteve për implementimin e programeve mbeshtetëse.

Rinegociimi dhe vazhdimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Post Telekomin e Kosovës për ofrimin e shërbimeve për pranimin dhe dergimin e shkresave, vendimeve dhe dokumentacionit tjetër të fermeret dhe institucionet tjera dhe anasjelltas.

Janë në përgatitje edhe memorandumet me institucione tjera si Autoriteti Menaxhues i MBPZHR-së, ATK, AUV, Agjencionin e Katastrit, Agjencionin e Statistikave, Agjencioni i Regjistrimit Civil dhe institucione tjera me interes për shkëmbimin e informatave të ndërsjella, draftet e këtyre marrëveshjeve janë të gatshme për nënshkrim dhe pastaj implementim.

Bashkëpunimi me BB dhe Danidën dhe Zyrën e Komisionit Evropian edhe këtë vit ka vazhduar dhe rezulton i suksesshëm që kanë qëllim mbështetjen e aktiviteteve të AZHB-së në implementimin e programeve të mbështetjes së fermereve si dhe mbështetjen e AZHB me logjistik dhe pajisje të TI.

Ka vazhduar mbështetja nga projekti i BE “ Mbështetje MBPZHR-së në të ardhmen për forcimin e strukturave administrative për programim, implementim dhe monitorim të fondeve të EU”. Ky projekt ka realizuar GAP analizën për AZHB dhe për AM, ka realizuar një mori trajnimesh për stafin e AZHB-së, AM dhe palët tjera me interes. Një ndër aktivitetet më të rëndësishme të këtij projekti është përgatitja e doracakëve dhe dokumentacionit tjetër për procesin e akreditimit të AZHB-së për dy masa, pakoja e akreditimit është finalizuar dhe tani ndodhet në përkthim.

Në AZHB edhe gjatë këtij viti janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara e të cilat janë varur nga zyrtarët e DAP gjegjësisht AZHB-së kurse ngecje ka pasur të aktivitetet e planifikuara e të cilat kanë pasur implikime buxhetore si : ndërtimi i objektit, themelimi i Drejtorive të reja, regrutimi i stafit etj., të cilat nuk janë varur nga AZHB.

Aktivitetet e planifikuara janë realizuar konform rregullores për detyrat dhe përgjegjësit duke pasur kujdes që gjatë implementimit të zbatohën të gjitha ligjet, U/A dhe procedurat e shkruara për të pasur kontroll të brendshëm gjatë kontrollit administrativ dhe kontrollit në terren. Edhe gjatë këtij viti kemi pasur ndarje të detyrave për të shmangur konfliktin e interesit si dhe zbatimin e parimeve të kontrollit në katër sy.

Trajnimet : DAP në bashkëpunim me Divizionet tjera të AZHB-së, projektin e BE-së “ Mbështetje MBPZHR-së në të ardhmen për forcimin e strukturave administrative për programim, implementim dhe monitorim të fondeve të EU-së” gjatë v.2016 ka organizuar dhe mbajtur trajnime të ndryshme për stafin e AZHB-së dhe stafin e Drejtorive Komunale:



- Trajnimi i stafit Komunal për shpалosjen e programit për vitin 2016 si dhe procedurat e aplikimit për subvencione bazuar në afancimin e softverit,
- Përdorimi i sLPIS –it versioni i avansuar nga zyrtarët e Divizionit të PD, zyrtarëve Konunal dhe Inspektoratit,
- Trajnimi i Inspektoratit për porcedurat e inspektimit për PD,
- Trajnimi i Inspektoratit për procedurat e inspektimit të PZHR-së,
- Trajnimi i inspektoratit për përdorimin e mobil LPIS-it në vend ngjarje (MOBILE LPIS),
- Trajnimi i trajnerëve,
- Transferimi i njohurive të tjerët,
- Trajnimi i stafit të AZHB-së për kriteret dhe procedurat e akreditimit,
- Trajnimi për menaxhimin e riskut dhe performancës,
- Trajnimi për Auditimin e mbrendshëm,
- Trajnim për kontrollin e mbrendshëm,
- Trajnimi për përgatitjen e dokumentacionit për akreditim,
- Trajtime tjera nga fusha e TI, përdorimi programeve kompjuterike etj.

Logjistika: Gjatë vitit 2016 me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve për zbatimin e programit për bujqësi dhe zhvillim rural kanë qenë në shfrytëzim gjithësejt 29 automjete nga zyrtarët e AZHB-së kryesisht nga inspektorati teknik për kontrollin e fermerëve për subvencione dhe grante.

Shumica e automjeteve në shfrytëzim kanë qenë automjete zyrtare të AZHB-së me përjashtim të 4 veturave të AUV të cilat janë huazuar për shfrytëzim sipas marrëveshjes duke marrë për bazë volumin shumë të madh të kontrollave në terren (mbi 28.000 kontrollera në vendngjarje e në mungesë të automjeteve). Ky vit ka qenë relativisht stabil sa i përket numrit të automjeteve për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara si në qendër e kryesisht në terren duke i'u falenderuar mbështetjes së zyrës së KE me 10 vetura të reja të cilat në masë të madhe e kanë zbut nevojën për logjistikë.

Automjetet në shfrytëzim nga AZHB-ja sidomos ato të marra nga MBPZHR kanë kaluar shumë kilometra dhe në masë të madhe janë amortizuar dhe gjatë këtij viti janë servisuar shpesh për arsye të defekteve të shpeshta. Dukuri e përsëritur edhe këtë vit ka qenë vonesa në servisim, kualitetit të dobët i servisimit me ç'rast kemi pasur shpenzime të konsiderueshme si dhe janë paraqitur pengesa për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara. Gjatë këtij viti sipas raportit të shpenzimeve të derivateve janë shpenzuar 46,423 litra karburante dhe janë kaluar 485,174 km kryesisht për kontrollera në vend ngjarje për PD, PZHR si dhe për riverifikim dhe superkontrollë.

Në shpenzimet e karburanteve dhe kilometrat e kaluara mund të mos janë përfshi të dhënat e të gjitha veturave në shfrytëzim nga AZHB-ja për shkak të mungesës së raporteve të dy veturave në muaj të caktuar. Këto shpenzime krahasuar me vitin e kaluar, në vitin 2016 janë më të ulta për 1331 litra ose 2.80 % për arsye të përdorimit të veturave me shpenzime më të vogla edhe pse janë kaluar 9678 km ma shumë. Gjatë analizave të normativit të shpenzimeve të automjeteve shihet se shpenzimi është kryesisht në suaza të normalës me një mesatare prej 9.40 L/ 100 km të kaluara që është mesatare shumë më e ulët se vitin e kaluar.



Republika e Kosovës
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

Raporti vjetor për derivatet e shpenzuara-2016

Nr	Lloji i autom	Targat	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	TOTALI	Shpenzimi l/km
1	KIA Sorento	3Z-172-16	51	54	0	106	100	99	97	166	-	111	0	0	784	10.62906725
2	Nisan	3Z-101-16	70	126	165	174		261	186	323	125	173	149	143	1813	10.4075775
3	KIA Sorento	3Z-167-16	119	62	171	180	60	191	296	323	300	192	252	233	2379	8.875540964
4	KIA Sorento	3Z-168-16	119	178	162	345	316	229	231	186	180	174	178	229	2527	8.483281858
5	KIA Sorento	3Z-169-16	50	155	163	206	109	234	418	247	295	209	259	283	2628	8.930270491
6	KIA Sorento	3Z-170-16	124	60	255	264	65	285	267	380	306	255	184	314	2759	8.367959722
7	KIA Sorento	3Z-171-16	54	179	177		116	175	298	413	281	312	284	250	2539	8.678561663
8	ToYota	3Z-177-16	49	116		238			386	458	399				1646	12.05949154
9	Toyora Rone	3Z-383-01	74												74	9.273182957
10	Shkoda	3Z-113-16		9	68	76	74	78	141	53		130	25	15	669	6.126934701
11	Toyota L.C	3Z-138-16		50	215	113	115	254	389	491	120	398	481	135	2761	12.42015295
12	KIA Sorento	3Z-166-16		66	174	186	64	277	386	386	431	377	306	314	2967	9.742242653
13	Toyota L.C	3Z-176-16		75					425	344	366	232	394	205	2041	13.32332398
14	Toyota Rune	3Z-387-01		56				109	245	295	240	327	344		1616	10.32983892
15	Toyota Rune	3Z-389-01		20						292	316	230	253		1111	9.692898273
16	Toyota L.C	3Z-124-16			30	70		215	273	435			336	304	1663	13.32425286
17	NissanTer.	3Z-139-16		50	323	180	69	332	404	398	371	297	364	331	3119	10.68040955
18	Toyota L.C	3Z-140-16			195	97		231	401		172	189	345	98	1728	12.41111829
19	Suzzuki	3Z-120-16				28		99							127	6.951286262
20	NissanTer.	3Z-337-01							274	397	401	325	493		1890	12.75906299
21	NissanTer.	3Z-352-01							384	262	306	417			1369	12.55042171
22	Shkoda Yeti	3Z-008-16									310	201	198	255	964	7.695377984
23	Shkoda Yeti	3Z-191-16									234	155	147	192	728	7.905310023
24	Shkoda Yeti	3Z-192-16									306	209	256	149	920	6.871312271
25	Shkoda Yeti	3Z-195-16									256	147	248	287	938	7.212055974
26	Shkoda Yeti	3Z-196-16									196	156	240	195	787	7.73312371
27	Shkoda Yeti	3Z-197-16									198	151	238	219	806	7.620308216
28	Shkoda Yeti	3Z-198-16									201	211	306	247	965	7.873694517
29	Shkoda Yeti	3Z-199-16									255	191	211	205	862	8.184580327
30	Shkoda Yeti	3Z-200-16									98	96	99	101	394	6.754671696
31	Shkoda Yeti	3Z-201-16									201	194	185	269	849	7.722394033
	Totali		710	1256	2098	2263	1088	3069	5501	5767	6,864	6059	6775	4973	46423	291.5897058

Table 5: Raporti i shpenzimeve të derivateve për vitin 2016




Figure 8: Derivatet e shpenzuara sipas muajve në v. 2016




Figure 9: Sasia e derivateve të shpenzuara sipas veturave




Figure 10: Shpenzimi i derivateve



Republika e Kosovës
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

Tab: 6 Numri i kilometrave të kaluara për vitin 2016

Nr	Lloji i automj	Targat	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	TOTALI
1	KIA Sorento	3Z-172-16	188	445	0	1690	579	1182	1337	1187	0	768	0		7376
2	Nisan	3Z-101-16	696	826	2083	1843		2411	1550	1902	1143	2018	1396	1552	17420
3	KIA Sorento	3Z-167-16	1361	552	2078	2858	187	2711	2985	3308	3183	2604	2386	2591	26804
4	KIA Sorento	3Z-168-16	1371	1822	2601	4106	3477	3546	2083	2585	1870	1537	2192	2598	29788
5	KIA Sorento	3Z-169-16	956	1908	1574	2632	936	3008	4265	2604	2560	2452	3133	3400	29428
6	KIA Sorento	3Z-170-16	1351	1196	3053	3059	1160	2656	2944	4661	3432	2573	2799	4087	32971
7	KIA Sorento	3Z-171-16	1066	2499	2090		1764	2276	3452	3733	3014	2975	3008	3379	29256
8	Toyota	3Z-177-16	535	965		3294			2649	3189	3017				13649
9	Toyota Roner	3Z-383-01	798												798
10	Shkoda	3Z-113-16		221	1528	1566	865	1729	1860	693		1781	392	284	10919
11	Toyota LC	3Z-138-16		696	985	1035	1029	2209	2592	3702	1252	3352	3296	2082	22230
12	KIA Sorento	3Z-166-16		82	2376	1662	1159	2495	3854	3749	4825	3819	2765	3669	30455
13	Toyota LC	3Z-176-16		1245					2562	2620	2748	1656	2841	1647	15319
14	Toyota Runer	3Z-387-01		249				681	2659	2694	2340	3500	3521		15644
15	Toyota Runer	3Z-389-01		200						3162	3200	2450	2450		11462
16	Toyota LC	3Z-124-16			515	482		1420	2468	2971			2053	2572	12481
17	NissanTer.	3Z-139-16		301	2914	1653	984	3166	3857	3784	3402	2958	3232	2952	29203
18	Toyota LC	3Z-140-16			1211	666		2016	2896		1322	1698	2782	1332	13923
19	Suzzuki	3Z-120-16				534		1293							1827
20	NissanTer.	3Z-337-01						1920	2875		2857	2661	4500		14813
21	NissanTer.	3Z-352-01						3284	2008		2563	3053			10908
22	Shkoda Yeti	3Z-008-16									3340	3135	2629	3423	12527
23	Shkoda Yeti	3Z-191-16									2597	2059	1873	2680	9209
24	Shkoda Yeti	3Z-192-16									3660	3298	3690	2741	13389
25	Shkoda Yeti	3Z-195-16									2800	2234	4131	3841	13006
26	Shkoda Yeti	3Z-196-16									2101	2166	3058	2852	10177
27	Shkoda Yeti	3Z-197-16									2046	1602	3191	3738	10577
28	Shkoda Yeti	3Z-198-16									2602	2256	3875	3523	12256
29	Shkoda Yeti	3Z-199-16									2838	2768	2815	2111	10532
30	Shkoda Yeti	3Z-200-16									986	1693	1519	1635	5833
31	Shkoda Yeti	3Z-201-16									2143	2626	3146	3079	10994
	Totali		8322	13207	23008	27080	12140	32799	49217	51427	67841	65692	72673	61768	485174

Table 6: Raporti i kilometrave të kaluara sipas muajve




Figure 11: Grafikoni i kilometrave të kaluara



Duke u bazuar në tabelat e shpenzimeve dhe kilometrave të kaluara të automjeteve për periudhën janar- dhjetor 2016 është evidente rritja e shpenzimeve të karburanteve krahasuar me vitin 2015 për 1331 l ose shprehur në % për 2.80% e kjo për arsye të rritjes së numrit të kontrollave në terren si pasojë e rritjes së numrit të masave si te grantet po ashtu edhe te pagesat direkte me theks në muajt ku numri i kontrollave ka qënë më i madhë. Sipas tabelave dhe grafikoneve shihet se volumi më i madh i punëve e sidomos të kontrollave në terren këtë vit ka qënë nga muaji korrik për arsye të vonesave në fillimin e implementimit të programeve e posaqërisht atij për PD-në.

Bazuar në përgjegjësitë e sektorit të logjistikës gjatë vitit 2016 janë zhvilluar edhe aktivitete të tjera konform përshkrimit të punëve dhe detyrave të punës. Edhe gjatë vitit 2016 janë kontraktuar zyrat e marra me qera në 4 regjione, kontrata këto të cilat janë menaxhuar në menyrë të rregullt duke përcjell përmbushjen e kriterëve të kontraktuara si dhe menaxhimi i shpenzimeve të energjisë dhe komunal. Gjithashtu gjatë vitit 2016 janë menaxhuar edhe shërbimet tjera në AZHB-së siç janë kontratat për mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit në qendër dhe të gjitha zyrave regjionale, për të cilat kontrata me vërejtje të vogla të kohë pas kohëshme nuk ka pasur probleme më të theksuara. Gjatë vitit janë bërë investime të vogla në mirëmbajtjen dhe renovimin e zyrave si renovimi i zyrave regjionale të Regjionit të Ferizajit dhe renovime të zyrave qendrore (1yerja e zyreve, rregullimi i klimatizimit dhe vendosja e aparatit për hapje elektronike të dyerve të dy kateve të AZHB-së me kartela).

Sektori i logjistikës ka organizuar dhe menaxhuar edhe aktivitetet tjera si furnizim me inventar, furnizim me pajisje të TI-së, furnizimi i zyreve me material , përkujdesja për hapësirat dhe kushtet e punës së zyrtarëve të AZHB-së dhe aktivitete tjera nga domeni i përgjegjësisë së sektorit. Prej të gjitha këtyre aktiviteteve vlen të përmendet furnizimi me TI nga Zyra e KE-së në Prishtinë dhe Buxheti Nacional, paisje këto të cilat kanë përmbush nevojat e AZHB-së për TI-në.

Zyra ligjore: Zyra ligjore ka vazhduar aktivitetet e planifikuara sipas përgjegjësive të përcaktuara me rregullore duke u marrë me pjesëmarrje në hartimin e rregulloreve, vendimeve dhe trajtimin e lëndëve me konteste për të cilat janë zhvilluar procedurat e nevojshme ligjore. Këtë vit në bashkëpunim me Projektin e BE-së “ Mbeshtetje MBPZHR-së “ është përgatitur rregullorja e re e AZHB-së mbështetur në të gjeturat e Projektit të cilat janë paraqitur në GAP analizë për detyrat, përgjegjësit dhe strukturën organizative të AZHB-së , rregullore kjo e bazuar në kërkesat e marreveshjes kornizë dhe marrëveshjes sektoriale e cila është proceduar për miratim në zyren ligjore të MBPZHR-së.

Pjesëmarrje aktive në hartimin e U/A për implementimin e programit për PD-në dhe PZHR-në për vitin 2017, duke përgatitur vërejtjet dhe sygjerime për U/A bazuar në vërejtjet e identifikuar gjatë implementimit të programit e sidomos gjatë procesit të ankimimit dhe procedurave për kthimin e mjeteve të përfituara në mënyrë të paligjshme si dhe futja në program dhe në U/A e kërkesës për garancion bankar për investimet në masën 103 dhe Ujitja e Tokave Bujqësore.

Pjesëmarrje aktive në shqyrtimin dhe përgatitjen e vërejtjeve dhe sygjerimeve për Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural e sidomos në pjesën ku ka të bejë me AZHB-në. Hartimi i planit legjislativ për vitin 2017 si pjesë e planit të MBPZHR-së me të cilin plan janë parashtruar kërkesa për hartimin e dy



rregulloreve për implementimin e Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural si dhe kërkesës së Projektit të KE-së dhe AKK-së (rregullorës për konflikt të interesit si dhe rregullores për kontrollin e brendshëm).

Janë hartuar një mori vendimesh për implementimin e programit si për pagesa direkte po ashtu edhe vendime për PZHR-në dhe vendime të tjera për nevoja të AZHB-së sipas kërkesës së Kryeshefit Ekzekutiv dhe Shefave të Divizioneve.

Edhe gjatë vitit 2016 zyra e pranimit dhe zyra ligjore e AZHB-së ka trajtuar një numër të madh të kërkesave dhe ankesave për programin e PD-së dhe PZHR-së duke krijuar databazë, përgatitja e kërkesave për gjetjen e lëndëve dhe procedimi i tyre te komisionet përkatëse për shqyrtim. Sipas vendimit të marrë në mbledhjet e stafit të lartë të AZHB-së shqyrtimi i kërkesave të fermerëve deri në marrje të vendimit për rrefuzim do të bëhet nga sektori përkatës i PD-së, shqyrtimi i ankesave të fermerëve në raportin e kontrollit në vendëngjarje nga divizioni i inspektoratit kurse shqyrtimi i ankesave të fermerëve pas marrjes së vendimit për refuzim do të bëhet nga komisionet e pavarura.

Për PZHR-në, ankesat e fermerëve janë trajtuar pas themelimit të listës së përfituesve të mundshëm për të mundësuar korigjimin e gabimeve eventuale gjatë procesit të vlerësimit të dosjes së aplikuesve. Janë formuar tri komisione të pavarura për shqyrtimin e ankesave me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv; një për shqyrtimin e ankesave për PD-në, një për shqyrtimin e ankesave për PZHR-në dhe një për shqyrtimin e ankesave pas autorizimit të pagesave.

Këto komisione të pavarura janë formuar nga zyrtarë të AZHB-së dhe zyrtarë të MBPZHR-së. Secili komision në përbërje ka 3 anëtarë të AZHB-së dhe 2 anëtarë të MBPZHR-së në mënyrë që ankesat të trajtohen në mënyrë sa më profesionale dhe më transparencë të plotë.

Sipas evidencave të zyres ligjore numri i ankesave është më i vogël se në vitin 2015 e sidomos vërehet një ulje e numrit të ankesave të PD-së.

Nr. ren.	Lloji I ankesave	Nr. I ankesave
1	PZHR	201
2	PD	176
	Total	377

Table 7: Numri i ankesave




Figure 12:Grafikoni i ankesave

Nga tabela dhe grafikoni i paraqitur shihet se numri më i madh i ankesave ka qenë për programin e PZHR-së para vendimit e sidomos në fazën kur projektet kanë qenë në procesin e listave preliminare. Gjithashtu duhet potencuar se një numër i konsideruar i kërkesave është zgjedh gjatë kontaktit të zyrtarëve përgjegjës me fermer me bashkëbisedim dhe sqarim i arsyes së refuzimit. Pritet që numri i ankesave për programin e vitit 2016 të vazhdojë së shqyrtuari edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2017 duke marrë për bazë se një numër i projekteve janë në proces të implementimit.

Pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të zyrës ligjore të AZHB-së kanë qenë edhe aktivitetet e pa planifikuara duke trajtuar rastet e kontesteve dhe shkeljeve të paraqitura gjatë procesit të implementimit të programit e sidomos mos zbatimi i U/A për PZHR-në kur ka të bëjë me mirëmbajtjen e investimeve për 5 vitet vijuese, tentimet për mashtrim etj.

Bazuar në U/A dhe procedurat e shkruara të AZHB-së lidhur me procesin e ankimimit në rastet kur përfituesi nuk i përmbahet kushteve të parapara me legjislacion, kërkohet kthimi i mjeteve të përfituara në mënyrë të paligjshme. Gjatë vitit 2016 janë përgatitur 132 kërkesa për padi përmes DL të MBPZHR-së dhe Avokatit të Shtetit për arsye të mos kthimit të mjeteve të përfituara në mënyrë të kundërligjshme.

Këtë vit gjatë kontrollit administrativ të aplikacioneve për PD-në dhe PZHR-në janë vërejtur edhe disa tendenca për mashtrim përmes falsifikimit të dokumenteve të ndryshme. Në të gjitha rastet e identifikuar si të dyshimta për falsifikim të dokumenteve AZHB-ja ka ngritur procedura për hetim prej policisë së Kosovës- Departamenti i Krimeve Ekonomike. Janë gjithsejt 50 lëndë 38 prej tyre të PZHR-së dhe 12 të PD-së .

Gjithashtu gjatë vitit 2016 janë ngritur 9 padi kundër AZHB-së me pretendimin se janë shkel procedura për të cilat Zyra Ligjore e AZHB-së në bashkëpunim me Divizionet përgjegjëse ka ofruar prova për rregullësinë të zbatimit e procedurave dhe kriterëve të përzgjedhjes sipas U/A dhe janë proceduar në gjykata.



Natyrë e punës së AZHB-së e sidomos gjatë procesit të kontrollit në terren në disa raste ka prodhuar situata të pakëndshme në zbatimin e legjislacionit në fuqi duke hasur në kundërshtime të fermerëve, mosbashkupim e në disa raste edhe forma të ndryshme të kërcënimit.

Ka raste kur zyrtarët e AZHB-së pengohën në zbatimin e detyrave zyrtare nga fermerë të pa përgjegjshëm. Kemi raste kur zyrtarët tanë kërcënohën në forma të ndryshme andaj në rastet kur nuk kemi mirëkuptim jemi të shtrënguar të paraqesim rastet në organet e sigurisë apo edhe të ngrisim padi ndaj tyre.

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e zyres ligjore të AZHB-së është bërë edhe monitorimi i zbatimit të Udhëzimeve Administrative dhe procedurave të shkruara për PZHR-në, PD-në, AP-në dhe KT-në dhe për këtë monitorim do të përgatitet një raport i veçantë me të gjeturat dhe propozimet për zbatim të legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu gjatë vitit është punuar në përgatitjen e pakos së akreditimit për sektorin ligjor i cili është kusht për akreditim.

Arkiva: Edhe gjatë vitit 2016 arkiva e AZHB-së ka zhvilluar të gjitha procedurat konform ligjit dhe rregulloreve për arkiva. Të gjitha njësitë organizative kanë zbatuar procedurat e distribuimit të dokumenteve zyrtare me referencë të veçantë të shkresave hyrëse dhe dalëse.

Mbetet problem i arkivës mungesa e hapsirës së nevojshme për arkivim duke i nisur nga numri shumë i madh i dosjeve e sidomos për PD-në.

Gjatë këtij viti për shkak të numrit shumë të madhë të dosjeve për arkivim e në mungesë të hapsirës kemi bërë kërkesë për dislokimin e një numri të konsideruar të dosjeve, por në mungesë të përgjigjes për gjetjen e hapsirës ende të gjitha dosjet nga viti 2016 janë në divizionet përkatëse.

Janë sistemuar të gjitha dosjet e vitit 2015 për PD-në, një pjesë e dosjeve të PZHR-së për vitin 2016 dhe është duke u bërë përpjekje për sigurimin e hapsirës për dosjet e mbetura.

Gjatë vitit 2016 janë zhvilluar trajnime konform pakos së akreditimit për menaxhimin e dokumentacionit, si dhe është përgatitur softveri për këtë menaxhim për të cilin janë zhvilluar trajnime dhe do të tentohet të futet në funksion gjatë vitit 2017.

Përmes arkivës gjatë vitit 2016 janë proceduar 5722 shkresa të ndryshme si vendime, ankesa, kërkesa, rekomandime, kontrata dhe shkresa të tjera të natyrës administrative të protokoluara dhe skanuara etj. Sfidë e arkivit të AZHB-së edhe për vitin 2017 do të jetë mungesa e hapsirës si dhe një zyrtari për mirëmbajtjen fizike të dosjeve të arkivuara, databaza e pranimit dorzimit të dosjeve fizike dhe zbatimi i procedurave për menaxhimin e dokumentacionit sipas doracakut.

Sfidat e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë: AZHB edhe gjatë këtij viti është përballur me një mori sfidash për realizimin e planit dhe aktiviteteve të planifikuara për implementimin e programit. Ndër sfidat më të rëndësishme janë:

- ✓ Numri i pamjaftueshëm i punëtorëve për realizimin e aktiviteteve të planifikuara konform programeve për mbështetje përmes pagesave direkte dhe granteve investive, për të zbatuar procedurat e shkruara për implementimin e programeve, si atij të PD-së po ashtu edhe të PZHR-së, duke marrë parasysh volumin shumë të madhë të aplikacioneve të cilët në vitin 2016 kanë kaluar shifrën prej 45000.



Kjo rritje e volumit të punëve, rritja e buxhetit, shtimi i masave të mbështetjes, kërkon rritjen e numrit të punësuarve deri në 121 të punësuar të rregullt të paraparë në rregulloren e organizimit të brendshëm të AZHB-së si dhe organogramit të ri të propozuar nga projekti i KE i cili ishte në mbështetje të AZHB-së.

- ✓ Për vitin 2017 kemi premtim për aprovimin e 10 pozitave për AZHB të cilat do të jenë të cilat pozita do ta zbusin këte mungesë me shpresë se me rishikimin e buxhetit do të aprovohen pozita shtesë.

Gjithashtu edhe këtë vit do të kemi marrëveshje bashkëpunimi për angazhimin e një numri të zyrtarëve me financim nga BB dhe jemi në konsultim me MPSHS.

- ✓ Jetësimi i organogramit të AZHB-së sipas ligjit dhe Rregullorës për Detyrat, Përgjegjësitë, Kompetencat dhe Strukturën Organizative të AZHB-së i cili definon qartë ndarjen e përgjegjësiave në Drejtori dhe sektore për të pamundësuar konfliktin e interesit si dhe kontrollin e mbrendshëm.

- ✓ Mos miratimi i kërkesave për rritjen e buxhetit në kategorinë paga dhe mëditje, dhe kategorinë mallra dhe shërbime. Kjo mungesë e buxhetit në kategorinë paga dhe mëditje, ka pasur si pasojë mos pagesën e punëve shtesë, punës jashtë orarit dhe pagesën e rrezikshmërisë për punëtorë si dhe pa mundësinë për organizimin e trajnimeve, seminareve dhe udhëtimeve studimore me qëllim ngritjen e njohurive profesionale të të punësuarve në AZHB.

Gjithashtu mungesa e mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime, për mbulimin e nevojave të AZHB-së për furnizime me pajisje , mjete pune e në disa raste edhe për material për zyra ka qenë pengesë në realizimin e aktiviteteve të planifikuara.

- ✓ Mungesa e hapsirave optimale të punës në disa zyra regjionale por edhe në zyret qendrore të AZHB-së, pajisja me inventar dhe material tjetër të domosdoshëm për punë normale. Edhe përkundër kërkesave të shumta për rritjen e buxhetit për mallëra dhe shërbime ai mbetet në vlerë prej 165,000.00 euro për vitin 2017 që do të jetë pengesë serioze për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara.



DIVIZIONI I MIRATIMIT TË PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT RURAL

Një ndër sektorët kryesor të cilët kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit është edhe Bujqësia dhe Zhvillimi Rural, për këtë arsye mbështetja (përkrahja) për investimet në fermat/ekonomitë bujqësore është i një rëndësie vendimtare për të përmirësuar sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë, për të rritur prodhimtarinë dhe cilësinë e produkteve, kualitetin, vlerën e prodhimit, standarde më të larta të jetesës, dhe rritjen përpunimeve të ndryshme bujqësore dhe rurale.

Gjithashtu qëllimi i përkrahjes së fermerëve përmes skemave mbështetëse është arritja e objektivit të përgjithshëm të PZHR-së që janë:

- Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë kosovare dhe zëvendësimi i importit.
- Krijimi i vendeve të reja të punës dhe shtimi i punësimit në viset rurale.
- Përkrahja e bujqëve, në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së.
- Përkrahja e zhvillimit ekonomik, social dhe territorial duke synuar rritje, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të kapitalit fizik.
- Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtitshme.

Gjatë vitit 2016 nga AZHB-ja - Gjegjësisht Dizioni i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural është bërë zbatimi i një pjese të PZHR-së – duke përfshirë masat ,nën-masat dhe sektorët e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që janë pjesë e PZHR-së te vitit 2016.

Këto masa dhe nën masa të Zhvillimit Rural të cilat janë implementuar gjatë vitit 2016 kanë qenë si në vijim:

1.Masa 101 „Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore”- duke përfshirë:

Sektorin - Pemë drufrutore (mollë,dardhë ,kumbull,vishnje,qershija,kajsia,pjeshka,ftoni),

Sektori - Pemë të imta(dredhëz, mjedër manaferra,boronica dhe aronia).

Sektori - Serra përfshirë patatet

Sektori - Depo për ruajtjen e perimeve ,

Sektori - Mishit (trashja e viçave),

Sektori – Mishit (trashja e brojlerëve).

Sektori i qumështit (lopë qumështore),

Table 4: Krahasimi i numrit të kontrolleve sipas kategorive 2015/2016.




Figure 37: Paraqitja grafike e krahasimit

- ❖ Pra, bazuar në tabelarin dhe grafikun krahasues, të prezentuar më lartë, në vitin 2016 kemi rritje të numrit të kontrolleve në të gjitha kategoritë (llojet) e kontrollit dhe në total ky numër në këtë vit është më i madhë përr 285 kontrolle apo 36.35 %.



Vështirësitë gjatë kontrollit në teren për Projektet e Zhvillimit Rural

- Mangësitë e përpilimit dhe detajizimit të kriterëve si dhe precizimi i detajeve teknike shpesh reflektohen gjatë kontrollit në teren dhe në procesin e hartimit të raporteve nga kontrolli në teren i cili bie ndesh me projektin e miratuar. Këtu duhet vënë në pah edhe gabimet e shumta teknike gjatë vlerësimit të tyre, mungesat në dokumentacion (që shpesh ndodh të mos dorozohet dokumentacioni komplet që nga zyrtarët rajonal e deri tek zyrtarët e vlerësimit apo autorizimit të pagesave.
- Duhet pasur parasysh edhe ndryshimet në nënmasat (sektorët) e reja që janë aplikuar këtë vit për të cilat ne nuk kemi pasur përgatitjet e duhura as teorike e as në mjete teknike (Masa 302 nënmasa 302.4 dhe 302.5 dhe Masa Ujitja) dhe shpesh na është dashur të improvizojmë (Matja e thellësisë së puseve, trashësisë së gypave dhe rezervuarëve të ujit etj.) dhe kjo paraqet një vështërsi në procesin e kontrollit,
- Mungesa e udhëzuesve apo doracakëve, si shtojca të programit, për standardet teknike të ndërtimit të shtallave, serrave pemishteve etj.,
- Mungesa e dixhitalizimit të parcelles (lokalitetit) ku do të realizohet investimi,
- Presionet e ndryshme dhe kërcnimet e inspektorëve gjatë kontrollit në teren,
- Numri i madhë i lëndëve për kontroll , pasi që inspektorët e angazhuar në kontrollin e PZHR-ve janë shumë të angazhuar edhe në kontrollin e Pagesave Direkte, vetëm javen e fundit të nëntorit dhe tri javet e muajit dhjetor janë kontrolluar 365 lëndë të masave të ZHR,
- Mungesa e ndarjes dhe e profilizimit të inspektorëve për kontrollin e Pagesave Direkte dhe kontrollin e Masave të ZHR,
- Motivimi i ulët për punë i inspektorëve në pamundësi të kompenzimit të rrezikshmërisë dhe pagesave për punë jashtë orarit të punës dhe vikendeve, të inspektorëve,
- Mbështetja e dobët logjistike për kryerjen e aktiviteteve të kontrollit (veturat e amortizuara, vonesat në servisim dhe cilësia e ulët e servisimit të automjeteve, GPS-at, Fotoaparate, shirit metër etj.),
- Vonesat në aplikim.

KONTROLLI PËR MASAT E PAGESAVE DIREKTE-SUBVENCIONET

Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë vitit

Spektori i Kontrollit për Pagesa Direkte ishte përgatitur që nga fillimi i muajit mars të vitit 2016, të startojë me kontrollë në terren dhe përkundër kërkesës që e kemi bërë vazhdimisht që të fillohet me kontrollë në terren më herët, vitin që po e lëmë pas ka filluar tek me datën: 20 Qershor 2016. Arsye për këtë ishte vonesa në përgatitjen e Programit për Pgesa Direkte dhe shtyerja e afatit të aplikimit, etj. Poashtu vlenë të ceket se këtë vit Aplikimi i fermerëve është përfshirë në një Aplikacion për të gjitha Masat e Pagesave Direkte dhe kontrolli është realizuar poashtu në një kontrollë të gjitha masat e Pagesave Direkte. Që domethënë se, Inspektorati një herë shkon për kontrollë tek fermeri dhe kryen kontrollin për të gjitha



masat që ka aplikuar për Subvencione, si për sipërfaqe ashtu edhe për krerë, ishte viti i parë që u aplikua kjo metodë e kontrollit edhe pse ishte me shumë vonesë sepse përafersisht kultura e grurit dhe perimkultura ishte gati se në fillim të korrjeve kur kemi startuar me kontrollë. Gjatë vitit 2016, Divizioni i Kontrollit ka funksionuar me një staf prej 36 + 12 (janë pranuar me kontratë prej 01.09.2016 deri në fund të vitit) si dhe nga një her kemi pas perforcime nga Divizioni i Pagesave Direkte për kontrollë në teren dhe për meaxhim të dokumentacionit në Zyrën Qendrore. Puna ka filluar filluar me një staf prej 35 Inspektorësh, me 16 automjete dhe mjetet e zakonshme të kontrollit: Odometer, Shirit matës, metër dore, lap-top dhe GPS.

Këtë vit me gjithë shtimin e volumit të punëve në fushën e Pagesave Direkte janë përballuar me sukses dhe efikasitet të lartë kontrollet në teren falë organizimit të mirë të punëve në qendër dhe menaxhimit efikas të punëve në praninë dokumentacioni nga Divizionet përkatëse, përgatitje dhe përcjellje në teren, organizim të ekipeve dhe menaxhimin e duhur në Divizionin e Kontrollit.

Këtë vit me shtimin dhe zgjerimin e gamës së projekteve është rritur dukshëm numri i kontrolleve të realizuara në teren dhe është evidente se ngarkesa e inspektoratit me kontroll terreni është tepër e madhe. Gjatë periudhës së kontrollit të pagesave Direkte-Për inspektim janë angazhuar 47 inspektorë në terren dhe 3 në Qendër, (Shefi, Koordinatorin dhe Shefi i Analizës së rrishtit dhe Projekteve të Zhvillimit Rural si dhe Zyrtarja)

Kontrolli për Pagesa Direkte është kryer në harmoni me Kriteret e Programit për Pagesa Direkte në Bujqësi 2016, dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr/03/2016, Për Pagesa Direkte në Bujqësi, sipas Neneve: 26 dhe 27, të këtij Udhëzimi gjithashtu në harmoni me Rregulloret dhe Procedurat e Kontrollit të AZHB-Divizionit të Kontrollit.

Kontrolli i Grurit

Gruri ka filluar me 01.06.2016-28.12.2016 gjithsejtë për kulturën e grurit kanë aplikuar;11895 fermer ju kanë nënshtruar kontrollit 8043 fermer, që rezulton një kontroll me 67,62%.

Ekipe në terren kanë qenë 17-18 ekipe, prej 01.09.2016 numri i ekipeve është rritur në 24-25 ekipe të kontrollit.

Kontrolli i Misrit dhe Lulediellit

Misër; kanë aplikuar gjithsejtë; 8007 fermer për Misër dhe janë kontrolluar;5599 fermer, në përqindjen e kontrollit të arritur me 69,93 %

Luledielli; kanë aplikuar gjithsejtë 7 fermer dhe janë kontrolluar;7 fermer, 100 % kontrolli

Në përgjithësi nuk ka pasur probleme,është një kontroll rutinë që nuk shkakton shumë kokëçarje. Pas korrjes grurit,mbeten parcelat me misër dhe luledielli dhe nuk është shumë e vështirë identifikimi i tyre. Problem i vetëm që paraqitet janë gabimet e digjitalizimit. Për kontrollin e misrit dhe lulediellit janë angazhuar 16-18 prej 01.09.2016 janë rritur në 24-25 ekipe të kontrollit.



Kontrolli i Elbit dhe Thekrës

Kanë aplikuar gjithsejtë; 176 fermer per Elbë dhe Theker dhe janë kontrolluar;176 fermer, 100%, është viti i parë qe ka filluar subvencioni per keto dy kultura.

Ekipe ne terren kanë qenë ;17-18 ekipe,prej 01.09.2016 janë rritur në 24-25 ekipe të kontrollit.

Kontrolli i Perimeve në fushë të hapur

Perime në fushë te hapur; kanë aplikuar; 5453 fermer, janë kontrolluar 3585 fermer, 65.74 % te kontrolluar. Fermerët me kultivimin e këtyre kulturave ka raste që gjatë aplikimit bëjnë skicime të ndryshme në krahasim me terrenin do të thotë në toka të vetat i kultivon por i'au ndrojnë vendet kulturave perimore dhe aty nuk pajtohet me verifikimin ë Inspektoratit në terren.

Ekipe ne terren kanë qenë ;17-18 ekipe,prej 01.09.2016 jane rritur ne 24-25 ekipe te kontrollit.

Kontrolli i Pemishteve

Kontrolli i Pemishteve - kanë aplikuar gjithsejtë;2817, janë kontrolluar;1758 fermer, 62.74 % te kontrolluar. Ekipe ne teren kane qene ;17-18 ekipe, prej 01.09.2016 jane rritur ne 24-25 ekipe te kontrollit.

Kontrolli i Vreshtave

Vreshtat; kanë aplikuar gjithsejtë; 2988 fermer, janë kontrolluar; 1431 fermer, 47,89 % fermer te kontrolluar. Ekipe ne teren kane qene ;17-18 ekipe,prej 01.09.2016 jane rritur ne 24-25 ekipe te kontrollit.

Kontrolli i Kafshëve dhe Bletëve

Problemet qe paraqiten ma se

- 1.Mungesa e matrikulave,po ashtu rënia e numrave të veshëve të krerëve të matrikular-matrikulat e dobëta.
2. Problem tjetër ashte se personat pergjegjes te AUV-it thuja se fare nuk bajnë rifreskim të të dhënave në databazë
3. Problem tjetër në këtë fushë kontrolli janë edhe zyrtarët komunal që shpesh ndodhë që aplikantëve nga një herë nuk u plotësohet aplikacioni dhe aplikantët i sjellën me aplikime të viteve të kaluara dhe nuk paraqesin gjendjen reale të lëvizjes së kafshëve,prandaj kur shkon inspektori në kontrollë ndeshet me fermerin dhe gjendja konkrete është krejt jashtë sistemit të vitit aplikues edhe pse ketë vit kemi pas më pak raste të tilla .

Ekipe ne teren kane qene ;17-18 ekipe,prej 01.09.2016 jane rritur ne 24-25 ekipe te kontrollit,

Kontrolli i Bletëve– Për kontrollin e Bletëve së pari e ka bërë te mundimshme kriteri i Autoritetit Menaxhues që një bletar të ketë mundësi shpërndarjeje të bletishtes në 7 bletishte dhe Inspektoratit ju shkakton shumë probleme në kontroll si dhe mundesia e manipulimit është evidente sepse me një marker te thjeshtë e ka të shënuar një NIF në kosheren e bletëve. Propozimi i ynë gjithnjë ka qenë dhe do të



mbetet që të kufizohet numri i bletishteve për një bletar në më së shumti 3 bletishte (vende) ne një bletishtë (vend) dhe NIF te jetë i markuar nga metali dhe i bllobuar.

Kontrolli i Materialit Fidanor

Kontrolli i Materialit Fidanor - Një kontroll që është futur në program qe tri vite,nuk kemi pasur shumë telashe meqë numri i aplikantëve është i vogël dhe kemi gjetur ekipet adekuat edhe nëse vazhdohet me subvencion edhe ne vitet e tjera atëherë nuk ka probleme sepse është kontingjent i vogël dhe përvoja e këtyre tri viteve do të transferohet te të gjitha ekipet. Kontrolli është kryer 100%.Kanë qenë gjithsejtë; 16 kontrole të realizuara për aplikantët e fidanëve.

Kontrolli i Pulave Vojse

Kontrolli i Pulave Vojse - Po ashtu është kontigjent i vogël edhe kjo masë është aplikuar për herë të tretë dhe nuk krijon probleme gjatë kontrollit nëse është dokumentacioni i precizuar. Kontrolli është kryer 100%,kështu që janë kontrolluar të gjithë aplikantët gjithsejtë: 62.

Kontrolli i Fëllanzave

Kontrolli i Fëllanzave - Po ashtu është kontigjent i vogël kan aplikuar 7 fermer dhe të gjith 7 janë kontrolluar 100% .

Kontrolli i Bujqësisë Organike

Kontrolli i Bujqësisë Organike - Po ashtu është kontigjent i vogël kan aplikuar 4 fermer dhe 4 jan kontrolluar 100% .

Shqyrtimi i Ankesave

Shqyrtimi i Ankesave – Për vitin 2016 është angazhuar një Ekip brenda Divizionit për shqyrtimin e Ankesave- Gabimeve të mundshme ose shqyrtimin e vërejtjeve nga ana e aplikantëve para Vendimit. Gjithsejt janë shqyrtuar 70 raste të cilave u janë kthyer përgjigje , (Qamil Mataj ,Djellza Berisha, Bahtie Kutleshi dhe Albulena Xhinovci)

Kontestet

Gjatë vitit 2016 Sektorin e Kontrollit për Pagesa Direkte ë kanë përcjellur në vazhdimësi është çështje që shkakton shum vonesa dhe devijime në kontrollë.Kjo është çështje pakashumë e neglizhimit të lëndëve seps nuk zgjidhet në kohën e duhur nga Stafi i Divizionit të Pagesave Direkte dhe Zyrtarëve Komunal të Pranimi të Aplikacioneve dhe pastaj lëndët lihen ansh ë harrohen dhe pas të gjitha afateve kërkohet kontrolli në teren.Afatizimi i përmbylljes së kontesteve është çështje e domosdoshme e cila reflektohet direkt në Kontrollin në Teren.

Edhe këtë vit në të gjitha kulturat është tejkalar norma e kontrollit paraparë me këtë udhëzim, dhe është



rritur numri i kontrolleve në krahasim me numrin e kontrolleve të viteve të shkuara.
Më poshtë e paraqesim një kronologji të përshkrimit për 4 vite se si ka ardhur duke u rritur numri i kontrolleve nga viti në vit.

Viti	Numri i Kontrolleve
2013	16556
2014	18745
2015	20171
2016	19370-Aplikant/ / Kontrolle-32098

Table 5: Krahasimi i kontrolleve për Pagesa Direkte sipas viteve



Republika e Kosovës
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

Nr	Numri i Landeve per teren -2016	Numri i Landeve te perfunduara	Numri i Landve te kthyer	Numri i landeve te pa kryera	Perqindja e kontrollit ne teren
1	694	694	694	0	100,00
2	1392	1392	1392	0	100,00
3	316	316	316	0	100,00
4	471	471	471	0	100,00
5	341	341	341	0	100,00
6	344	344	344	0	100
7	754	754	754	0	100,00
8	463	463	463	0	100,00
9	1097	1097	1097	0	100,00
10	992	992	992	0	100,00
11	98	98	98	0	100
12	27	27	27	0	100
13	29	29	29	0	100,00
14	544	544	544	0	100,00
15	636	636	636	0	100
16	253	253	253	0	100,00
17	703	703	703	0	100,00
18	31	31	31	0	100
19	70	70	70	0	100,00
20	49	49	49	0	100,00
21	919	919	919	0	100,00
22	1048	1048	1048	0	100,00
23	746	746	746	0	100,00
24	785	785	785	0	100,00
25	318	318	317	1	100,00
26	380	380	380	0	100,00
27	125	125	125	0	100,00
28	97	97	97	0	100,00
29	644	644	644	0	100,00
30	302	302	302	0	100,00
31	719	719	718	0	100,00
32	776	776	776	0	100,00
33	95	95	95	0	100,00
34	862	862	862	0	100,00
35	1684	1684	1684	0	100,00
36	496	496	496	0	100,00
37	70	70	70	0	100,00
	19370	19370	19370	0	100,00 %

Table 6: Qarkullimi i Lëndëve për Pagesa Direkte gjatë vitit 2016,Pranimi,Kontrolli,Kthimi dhe % e kontrollit të Realizuar



Nr	Kultura në Aplikim	Numri i Aplikantve	Numri i Kontrolleve	% e Kontrollit
1	Gruri	11895	8043	67,62 %
2	Lulë dielli	7	7	100 %
3	Misri	8077	5599	69,93 %
4	Elbi	154	154	100 %
5	Thekra	22	22	100 %
6	Perimet	5453	3585	65,74 %
7	Pemtaria	2817	1758	62,41%
8	Vreshta	2988	1431	47,89 %
9	Lopë Qumështi	8031	7766	96,70 %
10	Dele	1103	1030	93,38 %
11	Dhi	219	195	46,75 %
12	Dosa per Riprodhim	140	133	87,22 %
13	Bletë	2370	2314	97,64 %
14	Pula vojse	62	62	100,00 %
15	Materjal Fidanor	16	16	100 %
16	Fllanza	7	7	100 %
17	Bujqësia Organike	4	4	100 %

Table 7: Numrit i tërësishëm i aplikantëve, numri i aplikantëve të kontrolluar dhe %

Vërejtje : Lëndët e mbetura nën % e kontrollit të paraparë janë lëndë të cilat për arsye të ndryshme administrative janë refuzuar dhe nuk janë plasuar për kontrollë në teren.

Vështirësitë në teren gjatë kontrollit të Pagesave Direkte

1. Vonesa në shpalljen e Programit për vitin 2016 (që tashmë është bërë kronike).
2. Mungesa e paisjeve teknike për realizimit të kontrollit, Lap/top (sLPIS), GPS dhe mjete tjera jo të mjaftueshme, si dhe logjistika –Automjetet e pamjaftueshme, të amortizuara dhe të paservisuar si duhet vonesat në servisim.
3. Normat e larta të kontrollit.
4. Problemet me fermer të pandërgjegjshëm që nuk i përgjigjen kontrollit (shkaktojnë vonesa, pengim të inspektorëve në kryerjen e detyrave).
5. Gabimet në aplikim nga fermerët dhe Zyrtarët e Pranimi të Dokumentacionit dhe vonesat në zgjidhjen e problemeve dhe kontesteve nga ana e Divizionit të Pagesave Direkte dhe Departamentit të Teknologjisë Informativë.
6. Moskompletimi i programit.
7. Srafi mbështetës i pakualifikuar sa duhet.



Të Arriturat

- Marrë në tërësi kontrolli është realizuar me efektivitet dhe efikasitet të lartë teknik- profesional dhe moral prandaj nuk kemi pasur probleme të theksuara në procesin e kontrollit,
- Në këtë vit përkundër vështërsive kemi ngritje cilësore në procesin e kontrollit dhe hartimit të raporteve, pasi që raportet nga terreni janë shumë më konkrete dhe më të kompletuara me të dhëna për investimet e realizuara nga përfituesit e granteve dhe gjendjen në teren,
- Angazhimi maksimal në plotësimin e rekomandimeve (të gjeturave) të auditorëve për të dhënat që duhet të përmbaj raportit dhe evitimi i dobësive tjera,
- Largimi i praktikës së bërë te disa inspektor që gjat kontrollit në raport të japin vlerësime dhe krijimi i vetëdijes te inspektorati në teren, gjatë procesit të kontrollit, duhet të konstatoj gjendjen reale lidhur me investimet e realizuara nga përfituesit përkatësisht konstatimi lidhur me të gjeturat në vendinvestim,
- Lëndët nga Divizioni i Kontrollit tek Divizionet përkatëse janë proceduar brenda afateve ligjore, dhe për asnjë moment nuk kemi shkaktuar vonesa apo vështërsi në procesin e procedimit të lëndëve tek sektorët tjerë,
- Ulja në masë të madhe e shkallës së mashtrimit nga përfituesit e projekteve.

Konkluzionet

1. Kontrolli në terren ka rritur efikasitetin dhe cilësinë e veprimit, sa i përket cilësisë se Inspektimeve mund të themi se janë brenda kriterëve kualitativë, kjo arsyetohet me faktin se pas ex-post kontrolleve vërtetohet se raportet e hartuara nga inspektorati kanë qenë reale dhe brenda kriterëve të parapara për kontrollin në teren,
2. Ka vend për rritje të cilësisë së performacës edhe më tutje në punën e inspektoratit,
3. Përmirësimi i kushteve të punës dhe ambienteve të zyrave si dhe paisja me logjistikën e mjete të nevojshme të inventarit, automjete si dhe IT duhet të jetë prioritet në vitin vijues ,
4. Të planifikohet ulja e përqindjes (zvoglimi i mostrës) së kontrollit të masave të Pagesat Direkte, meqë normat e larta të kontrollit për Pagesa Direkte dhe vonesat në përgatitjen e Programit në tërësi çrregullojnë tërë ritmin e punës në AZHB.
5. Të sigurohet pagesa e rrezikshmërisë për Divizionin e Kontrollit si masë motivuese në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së punës duke u bazuar në rreziqet, presionet dhe kërcnimet nga fermerët gjithashtu edhe nga barja e sëmundjeve të ndryshme transmiseve të inspektorët gjat kontrolli i kafshëve, shpezëve dhe pickimi i rriqrave.
6. Të inicohet mbrojtja me ligj e inspektoratit para kërcnimeve dhe kërcnuesve, gjatë kontrollit në teren, përkatësisht nga sektori ligjor i AZHB-së dhe MBPZHR të ketë vëmendje më të madhe se deri ku po arrijnë procedurat e inicuar nga vet inspektorët në momentin e kërcnimit tek organet gjegjëse etj.



DIVIZIONI I IT & REGJISTRAVE

Gjatë vitit 2016 Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave ka bërë mirëmbajtjen e të gjithë regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë si:

- Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR),
- Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS),
- sLPIS-Mobile i cili përdoret për kontrollë në teren për sipërfaqe,
- Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte i cili përfshin keto module:
 - ✓ Moduli për aplikimit në zyret komunale dhe
 - ✓ Modulin për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB
- Softueri për Menaxhimin e Granteve i cili përfshin keto module:
 - ✓ Modulin për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë të granteve,
 - ✓ Modulin për menaxhimin e granteve,
 - ✓ Modulin për autorizimin e pagesave të granteve,
 - ✓ Moduli i kontrollit në teren për projekte të zhvillimit rural,
- Softueri për indikator si dhe
- Web faqja e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave ka bërë mirëmbajtjen e të gjithë kompjuterëve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë duke përfshirë edhe 7 (shtatë) Zyret Regjionale. Gjatë vitit 2016 Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave ka bërë menaxhimi e të gjithë shfrytëzuesëve (userëve) të domenit të zyrtarëve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për krijimit të llogarive zyrtare dhe vazhdimin e tyre për qasjen në domenin shtetror. Të gjithë zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë janë të qasur në server (share folder) për ruajtjen direkte të të dhënave në server. Nga Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave bëhet ruajtja (backup) i të gjitha të dhënave që janë të ruajtura në server (share folder), ruajtja (backup) e të dhënave për Softuerin për Menaxhimin e Granteve (në këtë softuer përfshihet menaxhimi i granteve, moduli i aplikimit për grante dhe plotësimi i kërkesës për pagesë në zyrët regjionale të AZHB-së, autorizimi i pagesave të granteve dhe moduli i kontrollit në teren) gjithashtu edhe ruajtja (backup) e të dhënave të serverit ku është instaluar Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR), ruajtja (backup) i të dhënave të softuerit për Menaxhimin e Pagesave Direkte si dhe ruajtja (backup) i të dhënave të Sistemit të Thjeshtësuar për Identifikimin e Parcelave të Tokës (sLPIS).

Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave gjatë vitit 2016 ka bërë përgaditjen e kampanjes për aplikim për vitin 2016 për Projekte të Zhvillimit Rural sipas masave dhe nenmasave të caktuara në Udhëzimin Administrativ për Projekte të Zhvillimit Rural si dhe përgaditjen e softuerit për miratimin e projekteve. Pas përgaditjes së softuerit është bërë trajnimi i zyrtarëve regjionalë të AZHB-së për regjistrimin e aplikacioneve në sistem si dhe u është dhënë mbështetje gjatë gjithë kohës së regjistrimit të aplikacioneve. Për Pagesa Direkte gjatë vitit 2016 është bërë përgaditja për aplikim e Regjistrat për Menaxhimin e Pagesave Direkte i cili përfshin dy module: moduli për aplikimit në zyret komunale dhe modulin për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB ku është bërë përgaditja për aplikim për të gjitha llojet e subvencioneve për vitin 2016 si dhe është bërë përgaditja e Sistemit të Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) ku është bërë kopjimi i të gjitha parcelave të vitit 2015 në vitin 2016 (për të lehtësuar aplikimin e fermerëve). Pas përgaditjes së kampanjes për aplikim për vitin 2016



është bërë trajnimi i zyrtareve komunal dhe u është dhënë mbështetje direkte zyrtareve komunal gjatë regjistrimit të aplikacioneve gjatë gjithë kohë se kampanjes për aplikim. Po ashtu gjatë vitit 2016 është përgaditur kampanja për aplikim për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë dhe therrjet e raportuara të gjedhit dhe akuakultur për tremujorin e parë TM1, TM2, TM3 dhe TM4 si dhe u është dhënë mbështetje zyrtareve komunal për aplikim.

Gjatë vitit 2016 Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë përmes projektit të Komisionit Europian është furnizuar me pajisje të Teknologjisë Informative ku kemi pranuar si donacion: 2 blade enclosure, 7 blade server, 2 MSA storage, 2 External Ethernet Switches, 1 unitreds, 1 ultrium tape drive, 5 fotokopje, 30 Desktop PC, 15 printera multifunksional, 39 laptopa, 5 workstation, 4 projektora, 35 monitora dhe 25 GPS.

Gjatë vitit 2016 është zhvilluar web aplikacioni i ri për menaxhimin e pagesave direkte ku përmes këtij aplikacioni bëhet aplikimi për të gjitha pagesat direkte. Ky aplikacion është i nderlidhur edhe me sLPIS-in Sistemi i Thjeshtëzuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës ku pas digjitalizimit të parcelave kalohet në mënyrë automatike në web aplikacionin e pagesave direkte dhe bëhet aplikimi për Pagesa Direkte. Me këtë web aplikacion të pagesave direkte behet kontrolli administrativ i aplikacioneve, procedimi i lendeve për kontroll në teren si dhe kthimi i lendeve në kontroll administrative pas kontrollit në teren, kalkulimi i pagesave, përpilimi i listave për pagese si dhe dërgimi i sms në mobil tek fermerit dhe dërgimi i vendimit në emalin e fermerit për të njoftuar lidhur me vendimin e marr për aplikacionin e tij. Me këtë web aplikacion behet komplet menaxhimi i pagesave direkte.

Në Grant Menaxhment përkatesisht në modulën për menaxhimin e granteve gjatë vitit 2016 është zhvilluar forma e dërgimit të sms në mobil tek fermerit dhe dërgimi i vendimit në emalin e fermerit për të njoftuar lidhur me vendimin e marr për aplikacionin e tij.

Gjatë vitit 2016 Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave ka bërë administrimin e të gjithë regjistrave që shfrytëzon AZHB-ja



Në këtë skemë mund të shihet lidhja e regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB):




Figure 38: Lidhja e regjistrave të AZHB-së

Në këtë skemë mund të shihet Sistemi i Komunikimit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë-AZHB-së, data bazat e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) si dhe komunikimi i rrjetit të internetit në mes të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) dhe Ministrisë së Administratës Publike përkatësisht Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) gjatë vitit 2016:



Republika e Kosovës
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë




Figure 39: Sistemi i komunikimit të AZHB-së



Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR)

Regjistri Elektronik i Fermerëve do të thotë listë e kompjuterizuar e të dhënave të hartuara nga ana e institucionit përkatës brenda Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (MBPZHR-AZHB) me qëllim të identifikimit të fermerëve që mund të përfitojnë nga mbështetja financiare nga autoritetet kombëtare dhe / ose burime të tjera, si dhe fermerët të cilët dëshirojnë të regjistrohen në bazë vullnetare. Regjistrimi i fermerëve është i rregulluar me "Udhëzim Administrativ nr.07/2011 për regjistrin e fermerëve" regjistrimi është vullnetar, obligativ është vetëm për fermerët që aplikojnë për grante dhe subvencione. Gjatë vitit 2016 është bërë plotësim ndryshimi i Udhëzim Administrativ nr.07/2011 për regjistrin e fermerëve.

Regjistri elektronik i fermerëve (eFR), Databaza e eFR-së është e instaluar në server të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) ku serveri është i hostuar në dhomën e servereve të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike ku gjatë gjithë kohës është funksional. Regjistrimi i fermerëve bëhet në zyrët komunale në Drejtoratet e Bujqësisë dhe në Zyrët Regjionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Krijimi i përdoruesve dhe administrimi i këtij regjistri bëhet nga Drejtorati i Regjistrave varësisht sipas pozitës së zyrtarit që duhet të ju krijohet përdorimi.

Regjistri Elektronik i Fermerëve (eFR) ka filluar të funksionoi në vitin 2012 dhe gjatë këtij viti janë regjistruar 16,608 fermer ndërsa në vitin 2013 kane qenë të regjistruar 26,603 fermer, në vitin 2014 kane qenë të regjistruar 34,775, në fund të vitit 2015 kane qenë të regjistruar 43166, ndërsa në fund të vitit 2016 përkatësisht me 31.12.2016 numri i fermerëve të regjistruar ka arritur në 50164 fermer në 37 komuna të Kosovës.

Gjatë vitit 2016 u është dhënë mbështetje direkte gjatë gjithë vitit zyrtarve komunal dhe zyrtarve regjional të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) për regjistrimin e fermerëve në Regjistrin Elektronik të Fermerëve (eFR).



Me poshtë në këtë diagram mund të shihni dallimet e numrit të fermerve nëpër vite të regjistruar në Regjistrin Elektronik të Fermerve (eFR):




Figure 40 :Numri i fermerëve të regjistruar nëpër vite 2012-2016

Në Regjistrin Elektronik të Fermerve (eFR) përfshihen të dhënat për fermerin, tokën në shfrytëzim, të dhënat për kafshë, mekanizmi bujqësor si dhe nënshkrimi i fermerit.

Për fermerin i kemi të dhënat për emrin, mbiemrin, emrin e babës, datëlindjen, numrin personal, gjuhën e fermerit, komunën, vëndbanimin, telefonin, e-mailin, koordinatat e fermës që mirren nga Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) emri i bankës dhe numri i xhirollogarisë, etj.

Për tokën në shfrytëzim i kemi të dhënat për tokën e punueshme si ara, kopshte, lëndinë e përhershme, pemishte, vreshta, pyje, të dhënat plotësohen për sipërfaqën e tokës në pronë në hektar dhe sipërfaqën e tokës në huazim me qëra, patate mbi 10 (dhjetë) hektar, drithëra mbi 50 (pesëdhjetë) hektar, bimë industriale, hortikulturë e hapur mbi 3 (tre) hektar, hortikulturë e mbuluar mbi 0.30 (zero pikë tridhjetë) hektar.

Për kafshë i kemi të dhënat për lopë qumështore, mëshqerra (mbi dy vite), dema (mbi dy vite), një deri në dy vite meshkuj, një deri në dy vite femra, dele për mbarështim, dele (desh, qingja, rrunza), dhi për mbarështim, dhi (cjep, keca, ftuja), derra nën 20 (njëzet) kg, dosat për mbarështim mbi 50 (pesëdhjetë) kg, derra tjerë, kuaj, gomarë, pula, zogj, bletë etj.

Për mekanizëm i kemi të dhënat për traktorë, motokultivorë dhe autokombanja, dhe është pjesa e nënshkrimit ku në këtë pjesë përfshihen të dhënat për datën e regjistrimit dhe vendin e regjistrimit.

Pas regjistrimit të fermerit gjenerohet NIF, "NIF" do të thotë Numri Identifikues i Fermës.



Pasi të bëhet gjenerimi i NIF-it është e mundur shtypja e çertifikatës së fermerit dhe aneksit me të dhënat e fermerit ku në aneksin e eFR-së nënshkruhet zyrtari përgjegjës gjatë regjistrimit dhe fermeri. Regjistri Elektronik i Fermereve (eFR) është i lidhur me Sistemin e Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) ku nuk mund të kalohet në sLPIS pa qenë i regjistruar në eFR.

Në skemën e mëposhtme mund të shihet procesi i regjistrimit të fermerit në eFR:




Figure 41:Procesi i regjistrimit të fermerit në eFR



Me poshtë mund të shihni Regjistrin Elektronik të Fermerve (eFR) i cili është web aplikacion dhe funksionon në tri gjuhë: Shqip, Anglisht dhe Serbisht:

The screenshot displays the eFR web application interface. At the top, there is a navigation bar with the Ministry's logo and name, and a user profile icon labeled 'Çkyçu'. Below this, a secondary navigation bar contains buttons for 'Home', 'EFR', 'Statistics', 'History', and 'Administration'. The main content area features a search section with tabs for 'Fermeri', 'Tokat në shfrytëzim', 'Kafshët', 'Makineria', and '>Nenshkrimi'. Below the tabs are input fields for 'NIF' and 'Nr. personal', along with a 'Kërkim i detajuar' checkbox. A toolbar includes buttons for 'Fermer i ri', 'Pastro fushat', and 'Kërko'. A summary bar indicates 'Nr. total i fermerëve 50164'. The central part of the interface is a table with the following columns: NIF, Nr. personal, Emri, Mbiemri, Emri i babës, Komuna, Vendbanimi/Fshati, and Kompania. The table contains several rows of data, with some cells containing ellipses (...). At the bottom of the table, there is a pagination control showing '1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 ... Rezultati kërkimit: 43337'. A footer toolbar contains icons for refresh, delete, add, edit, print, and export.

Figure 42 :Regjistri elektronik i fermerëve

Në eFR është i nderlidhur sLPIS-i (Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës) dhe Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte ku pasë regjistrimin ne eFR te dermerit kalohet në mënyrë automatike ne sLPIS për digjitalizim te parcelave të tokës, po ashtu në mënyrë automatike kalohet në Regjistrin për Menaxhimin e Pagesave Direkte ku bëhet aplikimi për të gjitha llojet e pagesave direkte.



Sistemi i Thjeshtesuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS)

Sistemi i Thjeshtesuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) përmes këtij sistemi gjatë vitit 2016 është bërë aplikimi për 49 kultura bujqësore ato janë: kultuart lavertare 7 kultura (grurë, farë gruri, misër, luledielli, elbi dhe thekra, për perime në fushë të hapur për 25 kultura (lakër, lulëlakër, spinaq, presh, qepë, hudhër, panxhar, karrota, domate, patëllxhan i zi, tranguj, patate, shalqinjë, pjepër, kungulleshë, kunguj misri, asparagu, brokoli, fasule monokulturë, bizele, kungulli, speci, marulla, majdanozi dhe rrepka) dhe për 16 kultura pemëtare permanente (molla, dardha, ftoi, mushmolla, kumbulla, kajsia, arra, lajthia, aronia, pjeshka, qershia, vishnje, dredhëza, manaferra, mjederr dhe boronica) si dhe vreshtat egzistuese. Pas hapjes së kampanjës për vitin 2016 janë trajnuar zyrtarët komunal për digjitalizimin e parcelave dhe u është dhënë mbështetje direkte gjatë digjitalizimit të parcelave gjatë kohës së aplikimit të fermëve për mbështetje direkte për sipërfaqe. Sistemi i Thjeshtesuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) është i nderlidhur me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit ku jemi duke i shfrytëzuar të dhënat për zonat kadastrale, kadastrin e parcelave, lumenjtë dhe hekurudhat.

Me poshtë mund të shihni se si duket lidhja e sLPIS-it me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit:




Figure 43: Lidhja e sLPIS –it me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit



Në këtë skemë mund të shihet funksionimi i sLPIS-it dhe sLPIS-MOBILE




Figure 44 :Skema e funksionimit të sLPIS dhe sLPIS –Mobile

Aplikimi i fermereve për mbështetje ka qenë në rritje të vazhdueshme nëpër vite. Më poshtë do ti paraqesim aplikimet e fermereve nëpër vite.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2011/12 (kampanja për aplikim për grurë është hapur në dhjetor të vitit 2011) për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 8,825 fermer dhe janë digjitalizuar 37,891 parcela me grurë me 43,008.02 hektar, ndërsa për misër kanë aplikuar 2,341 fermer dhe janë digjitalizuar 5,989 parcela me misër me 5,983.72 hektar dhe për luledielli kanë aplikuar 32 fermer dhe janë digjitalizuar 87 parcela me luledielli me 769.79 hektar.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2011/12 është 43,967 ndërsa i hektarve 49,761.53 ha.



Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2012/13 (kampanja për aplikim për grurë është hapur në dhjetor të vitit 2012) për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,728 fermer dhe janë digjitalizuar 49,106 parcela me grurë me 53,933.52 hektar, ndërsa për misër kanë aplikuar 3,726 fermer dhe janë digjitalizuar 11,202 parcela me 10,233.85 hektar dhe për luledielli kanë aplikuar 31 fermer dhe janë digjitalizuar 73 parcela me 487.12 hektar.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2012/13 është 60,381 ndërsa i hektareve 64,654.49 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2014 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,781 fermer dhe janë digjitalizuar 50,168 parcela me 52,003.32 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 17 fermer dhe janë digjitalizuar 41 parcela me 439.11 hektar, për misër kanë aplikuar 6,084 fermer dhe janë digjitalizuar 16,726 parcela me 15,171.26 hektar, për luledielli kanë aplikuar 14 fermer dhe janë digjitalizuar 37 parcela me 653.69 hektar dhe me perime në fushë të hapur kanë aplikuar 2,950 fermer dhe janë digjitalizuar 5,770 parcela me 3,889.05 hektar.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2014 është 72,742 ndërsa i hektareve 72,156.43 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2015 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 10,993 fermer dhe janë digjitalizuar 46,905 parcela me 47,289.34 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 17 fermer dhe janë digjitalizuar 49 parcela me 417.89 hektar, për misër kanë aplikuar 8,336 fermer dhe janë digjitalizuar 24,123 parcela me 21,091.00 hektar, luledielli kanë aplikuar 7 fermer dhe janë digjitalizuar 23 parcela me 304.57 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 2,738 fermer dhe janë digjitalizuar 8,959 parcela me 5,870.85 hektar dhe kultura pemtare permanente kanë aplikuar 4,291 fermer dhe janë digjitalizuar 7,700 parcela me 4,567.97 hektar.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2015 është 87,759 ndërsa i hektareve 79,541.62 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2016 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,859 fermer dhe janë digjitalizuar 55,008 parcela me 52,722.66 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 26 fermer dhe janë digjitalizuar 72 parcela me 775.78 hektar, për misër kanë aplikuar 7,978 fermer dhe janë digjitalizuar 24,091 parcela me 20,044.2 hektar, luledielli kanë aplikuar 2 fermer dhe janë digjitalizuar 2 parcela me 9.88 hektar, për theker kanë aplikuar 76 fermer dhe janë digjitalizuar 150 parcela me 245.08 hektar, për elb kanë aplikuar 156 fermer dhe janë digjitalizuar 329 parcela me 285.14 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 5,439 fermer dhe janë digjitalizuar 10,359 parcela me 7294.75 hektar, për bujqësi organike kanë aplikuar 7 fermer dhe janë digjitalizuar 43 parcela me 111.9 hektar dhe kultura pemtare permanente kanë aplikuar 5,795 fermer dhe janë digjitalizuar 9,284 parcela me 5,368.18 hektar.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2016 është 99,338 ndërsa i hektareve 86,857.57 ha.



Në këtë grafik mund të shihet numri i fermerëve që kanë aplikuar përmes sLPIS-it, numrin e parcelave dhe sipërfaqën e digjitalizuar gjatë kampanjave për palikim për subvencione 2011/12, 2012/13, 2014, 2015, 2016:




Figure 45: Numri i fermerëve që kanë aplikuar përmes sLPIS-it, numrin e parcelave dhe sipërfaqën e digjitalizuar gjatë kampanjave për aplikim për subvencione 2011/12, 2012/13, 2014



Më poshtë mund të shihni Sistemin e Thjeshtesuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS):




Figure 46: Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS)

Për kontrollë në terren nga inspektorët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë përdorën sLPIS-Mobile i cili funksionon pa qasje në rrjet të internetit (offline) ku ngarkohën të dhënat nga Sistemi i Thjeshtesuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) në sLPIS-Mobile vetëm me qasje të lloptopit në rrjet qeveritar dhe bartja e të dhënave nga sLPIS-Mobile në Sistemin e Thjeshtesuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS), ngarkimi i të dhënave bëhet shumë shpejt me një komandë e cila bën transferimin e të dhënave. Konfigurimi i sLPIS-Mobile në lloptop është bërë nga Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave po ashtu edhe konfigurimi i GPS-ve që përdorin inspektorët në terren.



Më poshtë mund të shihni sLPIS-Mobile i cili funksionon (offline) pa qasje në rrjet të internetit i cili përdoret nga inspektorët për kontrollë në teren:




Figure 47 :LPIS-Mobile



Softueri Grant Menaxhmenti

Ky softuer përmban:

- ✓ Modulim për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë
- ✓ Modulim e miratimit të granteve,
- ✓ Modulim e autorizimit të pagesave si dhe
- ✓ Modulim e kontrollit në teren

Softueri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë: Ky modul është instaluar në zyrët rajonale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë - AZHB ku bëhet aplikimi sipas masave dhe nënmasave të Projekteve të Zhvillimit Rural. Gjatë vitit 2016 ruajtja e të dhënave gjatë aplikimit

është bërë në server të AZHB-së dhe gjatë gjithë kohës zyrtarët përgjegjës të miratimit të projekteve kanë mundur të shohin të dhënat e fermave që kanë aplikuar sipas masave dhe nënmasave dhe shumën e projektit që ka aplikuar. Gjatë plotësimit të kërkesës për pagesë gjatë vitit 2016 janë regjistruar të gjitha fakturat që janë sjellur nga fermeret që kanë bërë kërkesë për pagesë, gjatë gjithë kohës zyrtarët e Autorizimit të Pagesave mund të shohin se sa fermer kanë bërë kërkesë për pagesë.

Më poshtë mund të shihni Softueri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë i cili funksionon në shtatë zyre rajonale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:




Figure 48: Softueri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë



Miratimi i granteve: Gjatë vitit 2016 Softueri për Miratimin e Granteve është përgaditur për miratimin e granteve të vitit 2016 sipas Udhëzimit Administrativ 2016. Pas aplikimit në softuerin për aplikim për grante, zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB fillojnë me poentimin e tyre sipas kriterëve që janë të rregulluara me udhëzimin administrativ të vitit përkatës, përmes këtij softueri gjenerohen letrat informuese, bëhet përgaditja e kontratës nënshkruhet nga fermeri dhe AZHB-ja, po ashtu përmes këtij softveri bëhet dhe dërgimi i sms-it në telefon mobil tek fermerët dhe dërgimi i vendimit në emalin e fermerit për t'u njoftuar lidhur me vendimin e marr për aplikacionin e tij.

Më poshtë mund të shihni softuerin për miratimin e granteve që shfrytëzohet nga zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:




Figure 49 :Softuerin për menaxhimin e granteve

Autorizimi i Pagesave: Gjatë vitit 2016 ky modul është përgaditur për Autorizimit të Pagesave të vitit 2016 ku kërkesat për pagesë janë plotësuar në zyret regjionale të AZHB-së, kalkulimi dhe autorizimi i pagesave është bërë nga zyrtarët e Autorizimit të Pagesave ku bëhet kalkulimi i fakturave dhe përpilimi i listave për kontrollë në teren dhe përgaditja e listës për pagesë.



Më poshtë mund të shihni softuerin për autorizimin e pagesave që shfrytëzohet nga zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:




Figure 50; Softuerin për autorizimin e pagesave

Moduli i kontrollit në teren: Ky modul përdoret nga Divizioni i Kontrollit ne Teren, ku përmes këtij moduli nga shefi i Divizionit të kontrollit caktohen lendet per kontroll ne teren dhe percaktohen per secilen lende nga dy (2) inspektor.

Pas definimit të lëndëve, përmes modulit të inspektorëve, secili inspektor sheh lëndët që ju kanë caktuar për inspektim. Pas kontrollit në terren inspektorët qasen në këtë modul ku në sistem plotësojnë të gjeturat ne teren dhe ne menyre automatike raporti kalon tek shefi apo personi përgjegjës te Moduli te Kontrollit, ku dhe bëhet vlersimi/pranimi i kontrollit.

Përgjegjësitë e Divizionit të Kontrollit, e bëjnë pranimin e lëndës dhe vlersimin e raportit të kontrollit në terren, dhe pas këtij vlersimi, lënda bartet në mënyrë automatike tek departamentet përkatëse. Nëse është kontrolli i I-rë, atëherë lënda bartet tek Miratimi i Projekteve ndërsa nëse lënda është e kontrollit të II-të, lënda bartet tek Autorizimi i Pagesave.



Më poshtë mund të shihni modulën e kontrollit në terren që shfrytëzohet nga inspektorët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:




Figure 51: Moduli i Kontrollit

Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte

Softueri për Menaxhimin e Pagesave Direkte: Ky web aplikacion përfshin dy module: moduli për aplikimit në zyret komunale dhe modulën për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB. Përmes këtij web aplikacioni është bërë aplikimi për të gjitha pagesat direkte për sipërfaqe (grur, miser etj, kultura permtare permanente) si dhe të gjitha aplikimet për krerë (lopë qumeshtore, dele, dhi, blet etj.). Ky aplikacion është i nderlidhur edhe me sLPIS (Sistemi i Thjeshtezuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës) ku pas digjitalizimit të parcelave bëhet aplikimi përmes këtij web aplikacioni. Më web aplikacionin e pagesave direkte bëhet kontrolli administrativ i aplikacioneve, procedimi i lëndëve për kontroll në terren, kalkulimi i pagesave, përpilimi i listave për pagese si dhe dërgimi i sms-it në telefon mobil tek fermerët dhe dërgimi i vendimit në emailin e fermerit për t'u njoftuar lidhur me vendimin e marrë për aplikacionin e tij, përmes këtij web aplikacioni bëhet komplet menaxhimi i pagesave direkte. Gjatë vitit 2016 Divizioni i IT dhe Regjistrave në këtë web aplikacion ka bërë krijimin e shfrytëzuesëve (userëve), rikthimin në aplikim të aplikacioneve që kanë bërë gabime zyrtarët komunal gjatë aplikimit si dhe mirëmbajtjen e të dhenave.



Më poshtë mund të shihet Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte

Subsidies

Search filters: Name, SubsidySubtypeId, Category, SubsidyGroupId

Name	SubsidySubtypeName	UnitMeasureName	PriceType	Category
Akuakulturë	Tjera	Copë	Fiks	Vjetor
Aronia	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Arra	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Asparagü	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Bizele	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Bletë	Bletë	Copë	Fiks	Vjetor
Boronica	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Brokoli	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Buallica	Gjedhë	Krerë	Fiks	Vjetor
Bujqësia organike	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Dele për mbarëshitim	Dele dhe Dhi	Krerë	Fiks	Vjetor
Dhi për mbarëshitim	Dele dhe Dhi	Krerë	Fiks	Vjetor
Domate	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Dosat për riprodhim	Derra	Krerë	Fiks	Vjetor
Dredhëza	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor

Page 1 of 62

Figure 52: Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte



Web faqja

Mirëmbajtja e ueb faqës së Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) bëhet nga Divizioni i IT dhe Regjistrave. Gjatë vitit 2016 janë publikuar të gjitha thirrjet për aplikim për Grante dhe Subvencione, formularët për aplikim, listat e përfituesve të granteve dhe subvencioneve, udhëzuesit për aplikues, udhëzimet administrative si dhe materiale të ndryshme informuese të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Publikimi i këtyre informatave është bërë në gjuhën Shqipe dhe Serbe.

Me poshtë mund të shihni se si duket web faqja e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë




Figure 54 : Web faqja e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë